

UNIVERSITETI I EVROPES JUGLINDORE
UNIVERZITET NE JUGOISTO~NA EVROPA
SOUTHEAST EUROPIAN UNIVERSITY



FAKULTETI I SHKENCAVE SHOQERORE
FAKULTET NA SOVRENENI OPJ~TESTVENI NAUKI
FACULTY OF CONTEMPORARY SOCIAL SCIENCE

Drejtimi: Administrimi Publik

Cikli i dytë: Master

TEZA E MASTERIT

Tema:

**„ Bashkëpunimi ndërkufitar i Komunës së Strugës
dhe Pogradecit”**

Mentori :

Prof.Dr. Agni Aliu

Kandidati:

Etem Etemi

Tetovë, 2019

„Këtë punim ja dedikoj familjes, vajzës dhe bashkëshores sime të dashur për përkrahjen dhe përkushtimin që më dhanë gjatë gjithë kohës së studimeve.“

„Faleminderimi tjetër i takon Komunës së Strugës dhe të Pogradecit për bashkëpunimin dhe ndihmën që ma kanë bërë.“

PËRMBAJTJA

PJESA E PARË

Hyrje	11
Metodat hulumtuese dhe teknike	12
Hipotezat	12
KAPITULLI I PARË	13
1. Të dhënat teorike mbi qeverisjen lokale	13
1.1 Nocioni.....	13
1.2 Përkufizimi.....	13
1.3 Rëndësia dhe zhvillimi.....	14
2. Karakteristikat themelore të Qeverisjes lokale	15
2.1 Qeverisja lokale dhe demokracia.....	15
2.2 Qeverisja lokale si kategori e sistemit politik	15
2.3 Qeverisja lokale si e drejtë e qytetarëve për të marrë pjesë në mënyrë të drejtëpërdrejtë ose përmes përfaqësuesve të vet në zgjidhjen e çështjeve me karakter	16
2.4 Qeverisja lokale dhe finansimi i saj.....	16
2.5 Qeverisja lokale dhe fushëveprimi i saj	17
2.6 Qeverisja lokale dhe ndarja territoriale.....	17
2.7 Qeverisja lokale dhe bashkëpunimi i saj.....	18
2.8 Raporti i organeve të pushtetit lokal me organet e pushtetit qendror.....	19
2.9 Qeverisja lokale dhe mbrojtja juridike	19
KAPITULLI I DYTË	21
3. Bashkëpunimi nderkufitar dhe rajonal	21
3.1 Bashkëpunimi i brendshëm i komunave.....	21
3.2 Bashkëpunimi ndërkombëtar i komunave.....	21
3.3 Bashkëpunimi i komunave me organizata ndërkombëtare.....	21
3.4 Anëtarësimi i komunave në asociacionet ndërkombëtare me karakter lokal.....	22
3.5 Anëtarësimi i komunave në asociacionet rajonale.....	23
3.6 Anëtarësimi në komunave asociacionet ballkanike.....	25
4. Korniza juridike që rregullon bashkëpunimin nderkufitar	26
4.1 Konventa Evropiane për Veteqeverisje lokale.....	26
4.2 Kushtetuta e R së Maqedonisë.....	26
4.3 Kushtetuta e R së Shqipërisë.....	27
4.4 Ligji mbi Qeverisjen lokale të R. së Maqedonisë	28
4.5 Ligji mbi Qeverisjen lokale të R. së Shqipërisë.....	29
4.6 Ligji mbi ndarjen territoriale të R së Maqedonisë.....	29
4.7 Ligji mbi ndarjen territoriale të R së Shqipërisë.....	30

4.8 Ligji mbi zgjedhjet lokale të R së Maqedonisë.....	30
4.9 Ligji mbi zgjedhjet lokale të R së Shqiperisë.....	31
4.1.1 Ligji mbi finansimin e Qeverisjes lokale të R së Maqedonisë.....	31
4.1.2 Ligji mbi finansimin e Qeverisjes lokale të R së Shqiperisë.....	32
4.1.3 Ligji për zhvillimin e barabartë rajonal	32
4.1.4 Marrëveshjet bilaterale dhe multilaterale të njësive të qeverisjes lokale.....	33
KAPITULLI I TRETË.....	34
5. Komuna e Strugës	34
5.1 Organizimi dhe funksionimi i Komunës së Strugës	36
5.2 Ndarja e Komunës nëpër sektorë, degë etj.	37
6. Komuna e Pogradecit	38
6.1 Organizimi dhe funksionimi i Komunës së Pogradecit	39
6.2 Ndarja e Komunës nëpër sektorë, degë etj.	40
6.3 Bashkëpunimi ndërkufitar i Komunës së Pogradecit.....	47
 7. Analizë krahasuese e nivelit të rritjes së bashkëpunimit ndërkufitar.....	52
 8. Shtojcë.....	58
 9. Shqyrtime përfundimtare.....	68
 10. Literatura e shfrytëzuar.....	70

ABSTRAKT

Bashkëpunimi i njësive të vetëqeverisjes lokale është një nga karakteristikat themelore të qeverisjes lokale sidomos një vend të rëndësishëm ka bashkëpunimi ndërkufitar në mes të Komunave në veçanti duhet pasur parasysh lëvizjen e lirë të mallrave, qytetarëve dhe shërbimeve si dhe rritjen e shkallës së zhvillimit të shumë fushave si ato ekonomike, kulturore, turizmit, ndertimtarisë, tregtisë etj. Njësitet e vetëqeverisjes lokale i'u mundësojnë qytetarëve t'i realizojnë interesat e tyre me karakter lokal. Organet e pushtetit lokal duhet që të organizohen sa më mirë që të jenë në gjendje t'u ofrojnë shërbime të ndryshme banorëve të komunave për t'ua plotësuar nevojat me karakter lokal. Gjatë ushtrimit të funksionit të tyre organet e pushtetit hasin në vështirësi dhe probleme për të ofruar shërbime të shpejta dhe cilesore. Konkretisht tema në fjalë ka të bëjë me organizimin dhe funksionimin e Komunës së Struges dhe Pogradecit si dhe bashkëpunimin ndërkufitar në mes tyre, në disa fusha ku ato kanë interesa të përbashkëta. Bëhet fjalë për dy komuna të cilat ndodhen në bregun e Liqenit të Ohrit duke i ndejtur njëra tjetrës përballë që llogariten në qytetet më të bukura shqipëtare. Ato janë dy qytete të vjetra që historikisht kanë bashkëpunuar për faktin se janë afër njëri me tjetrin dhe natyrisht bashkëpunimi ka qënë i domosdoshëm, bile për ca fusha edhe në kohën e ish Republikës Federative të Jugosllavisë edhe pse kufijtë ishin të mbyllur. Pas shpërbërjes së Jugosllavisë respektivisht perfundimit të periudhës diktatoriale të Republikës së Shqipërisë hapet rruga për një bashkëpunim më të zgjeruar ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Maqedonisë gjithashtu edhe qyteteve ndërkufitare. Hapja e kufirit me Republikën e Shqipërisë është një mundësi reale që Republika e Maqedonisë Veriore të mund ti realizojë nevojat jo vetëm në fushën e transportit duke shfrytëzuar Portin e Durrësit por edhe të rrisë shkallën e bashkëpunimit reciprok edhe në shumë fusha të tjera: fushën ekonomike, energjetike, bujqësi, ndërtimtari, turizëm, etj. Çështje e vërteta bashkëpunimi në disa fusha ka ekzistuar edhe shumë më herët, mirëpo vazhdimisht ka pasur ngecje në projektet e përbashkëta si psh: në ndërtimin e infrastrukturës rrugore (ndërtimin e hekurudhës, ndërtimin e autostradës, etj.), projekte të cilat janë përfunduar nga pala shqiptare. Në këtë kohë filloi qarkullimi i njerëzve dhe mallrave si dhe bashkëpunimi në mes dy qyteteve bregliqenore me fokus të vecantë në fushën e mbrojtjes së mjedisit jetësor dhe zhvillimin e mëtutjeshëm të turizmit. Duke u nisur nga fakti se Liqeni i Ohrit si një resurs shumë i rëndësishëm, i cili që nga Viti 1981 është edhe nën mbrojtje të UNESCO-s bashkë me Qytetin e Ohrit. Niveli i bashkëpunimit të bashkëpunimi i këtyre Komunave është i domosdoshëm. Kohëve të fundit i kushtohet rëndësi rregullimit të bregut të gjelbërt të

Liqenit të Ohrit, duke i larguar ndërtimet që nuk i përmbushin standardet për të qënë nën mbrojtjen e UNESCO-s. Komunitat bregliqenase të Maqedonisë Veriore dhe atë Komuna e Ohrit dhe Strugës duhet të ndjekin shembullin e Komunës së Pogradecit. Metodatat kryesore të përdorura në këtë punim janë: metoda historike, krahasuese dhe empirike. Gjithashtu, ky punim përmban edhe të dhëna parësore dhe dytësore, pra ka një mori tekstesh dhe punime shkencore të analizuara si dhe janë mbledhur informacionet e nevojshme përmes anketës dhe intervistave me kryetarë të komunave.

Fjalët kyçe:

Bashkëpunimi i vetëqeverisjes Lokale, Vetëqeverisja Lokale, Komuna e Strugës, Komuna e Pogradecit, Liqeni I Ohrit, decentralizimi.

АБСТРАКТ

Соработката на единиците на локалната самоуправа е една од основните начела на локалната самоуправа, особено затоа што е важна прекугранична соработка помеѓу општините, особено ако се земе предвид слободното движење на стоки, граѓаните и услугите и да се зголеми нивото на развојот на многу области. како што се економски, културен, туризам, градежништво, трговија и др. Единиците на локалната самоуправа им овозможуваат на граѓаните да ги остварат своите локални интереси. Органите на локалната самоуправа треба да се организираат што подобро за да бидат во состојба што подобро да им служат на граѓаните а со тоа што подобро да им ги исполнат нивните барања. Во вршењето на својата функција, надлежните органи се соочуваат со тешкотии и проблеми И тоа при обезбедување на брзи и квалитетни услуги. Поточно, темата се однесува на организирање и функционирање на Општина Струга и Поградец, како и прекуграничната соработка меѓу нив, во некои области каде тие имаат заеднички интереси. Се работи за две Општини кои се наоѓаат во Брегот на Охридското Езеро една спроти друга кои се рацунуваат како најубави албански градови. Тие се две стари градови ктo хисториски соработувале, поради фактот што се блиску и нормално е да соработката била неопходна, и за време на Бивша Федеративна Република Југославија иако границите во тоа време беа затворени. После распаѓот на Југославија односно после завршување на диктаторската власт во Република Албанија се отвара врата за една поширока соработка помеѓу Република Албанија и Северна Република Македонија исто така и меѓуграничните градови. Отворањето на границата со Република Албанија овозможи реална можност да Северна Република Македонија ги реализира потребите не само на областа на транспортот, користејќи го Пристаништето во Драч, но и да го да се зголеми нивото на меѓусебна соработка во многу други области: економски, енергетски, земјоделски, градежништво, туризам и др. Вистината е дека соработката во некои области постоеше одамна, но секогаш има доцнења во заеднички проекти како што се: патна инфраструктура (железничка конструкција, изградба на автопати и сл.), Проекти кои се завршени од албанската страна. Во тоа време, движењето на луѓето и стоките и соработката меѓу двата крајбрежни градови започна со посебен фокус на заштитата на животната средина и натамошниот развој на туризмот.

Почнувајќи од фактот дека Охридското Езеро како многу значаен ресурс, кој од 1981 Година е под заштита на УНЕСКО, заедно со Градот Охрид. Нивото на соработката на овие општини е неопходен. Во последно време се дава посебна важност на средување на зелениот појас на Охридското Езеро, отстранувајќи ги објектите што не ги исполнуваат стандардите за да бидат под заштита на УНЕСКО. Крајбрежните Општини на Северна Република Македонија и тоа Општина Охрид и Струга треба да го следат примерот на Општина Поградец. Главните методи што се користени во овој труд се: хисториската метода, компаративната и емпириската метода. Исто така овој труд содржи и примарни и секундарни податоци, значи има многу текстови и научни трудови кои се анализирани како и се собрани потребни информации преку анкети и интервјуа на градоначалници.

Клучни зборови:

Соработка на локална самоуправа, локална самоуправа, Општина Струга, Општина Поградец, Охридско Езеро, децентрализација.

ABSTRACT

Co-operation of local self-government units is one of the fundamental characteristics of local government, especially an important part has the cross border cooperation between municipalities, in particular the free movement of goods, citizens and services as well as the increase of the degree of development of many areas such as economic, cultural, tourism, construction, trade etc. Local self-government units enable citizens to realize their local interests. Local government organs should be better organized to be able to offer different services to local residents to meet their local needs. During the exercise of their function, the authorities face difficulties and problems in providing fast and quality services. Specifically, the subject in question relates to the restriction and functioning of the Municipality of Struga and Pogradec as well as cross-border cooperation between them, in some areas where they have common interests. It is about two municipalities that are located on the shore of Lake Ohrid, facing each other in front of the most beautiful Albanian cities. They are two old cities that historically have collaborated for being close to each other and of course collaboration was necessary, even in some areas even in the time of the former Federal Republic of Yugoslavia, even though the borders were closed. After the dissolution of Yugoslavia, respectively the end of the dictatorial period of the Republic of Albania, opens the way for a wider cooperation between the Republic of Albania and the Republic of North Macedonia as well as the neighboring cities. The opening of the border with the Republic of Albania is a real possibility for the Republic of Northern Macedonia to fulfill its needs not only in the field of transport by exploiting the Port of Durres but also in enhancing the level of mutual cooperation in many other fields: economic, energy, agriculture, construction, tourism, etc.

The truth is that cooperation in some areas has existed a long time ago, but there have always been delays in joint projects such as: road infrastructure (railway construction, highway construction, etc.), projects that have been completed by the Albanian side. At this time, the movement of people and goods and the co-operation between the two coastal cities began with a particular focus on the protection of the environment and the further development of tourism. Given the fact that Lake Ohrid is a very important resource, which has been under UNESCO protection since 1981 together with the City of Ohrid. The level of cooperation and cooperation of these Municipalities is indispensable. Recently, the importance of regulating the green shores of Lake Ohrid has been remedied, removing constructions that do not meet UNESCO-protected standards. the example of the Municipality of Pogradec.

The main methods used in this paper are: theoretical, comparative and empirical methods. This paper also contains primary and secondary data, so there are a number of texts and scientific papers analyzed and the necessary information is collected through a survey and interviews with mayors.

Key Words:

Cooperation of Local Self-Government, Local Self-Government, Municipality of Struga, Municipality of Pogradec, Lake Ohrid, decentralization.

HYRJE

Bashkëpunimi i Njësive të Vetëqeverisjes Lokale luan një rol të rëndësishëm në ditët e sotme duke pasur parasysh faktin se jemi në periudhën e globalizimit si një mundësi për komunikim të lirë për realizimin e projekteve të ndryshme jo vetëm të karakterit lokal por edhe ato të karakterit ndërkombëtar. Koncepti se përmes bashkëpunimit korrekt dhe të mirëfillte çdo herë rezulton me suksese të larta gjë që me ka motivuar që t'i rrekem më me përkushtim hulumtimit të kësaj karakteristike të rëndësishme të Vetëqeverisjes Lokale.

Në bazë të Dispozitave Juridike të mbrendshme, bashkëpunimi i njësive zë një vend të rëndësishëm duke lejuar që kjo të bëhet në mes të Njësive të Vetëqeverisjes Lokale mbrenda shtetit në mes të Njësive të Vetëqeverisjes Lokale jashtë shtetit (Binjakëzimi i Komunave), në mes të Njësive të Vetëqeverisjes Lokale dhe OJQ-ve të ndryshme, në mes të Njësive të Vetëqeverisjes Lokale dhe Organeve të Pushtetit Qëndror, në mes të Njësive të Vetëqeverisjes Lokale dhe Organizatave Nderkombetare: UNICEF, FAO, MOR, USAID, UNESCO, etj.si dhe anëtarësimi i Njësive të Vetëqeverisjes Lokale në organiatat ndërkombëtare të nivelit lokal. Bashkëpunimi i Njësive të Vetëqeverisjes Lokale rregullohet edhe me Konventën Evropiane për Qeverisje Lokale, e miratuar në 15.10. 1985 në Strasburg¹, Lejohet Bashkëpunimi i Njësive të Vetëqeverisjes Lokale në të gjitha fushat , duke realizuar projekte të përbashkëta që do të ndikonin në mënyrë të drejtëpërdrejtë në zhvillimin e Njësive të Vetëqeverisjes Lokale. Për mënyrën e bashkëpunimit vendos Këshilli i Komunës me shumicën e anëtarëve të këtij organi vendimmarrës. Gjatë këtij hulumtimi vëmendje të posaçme do t'i kushtojmë bashkëpunimit të Komunës së Strugës dhe Komunës së Pogradecit, duke u përpjekur të gjejmë forma dhe metoda për rritjen e nivelit të bashkëpunimit për të shfrytëzuar në mënyrë sa më të drejtë resurset natyrore që disponojnë këto komuna. Hipoteza qëndron pikërisht në rritjen e bashkëpunimit që të ndikojë në zhvillimin e këtyre komunave në disa degë si: turizëm, ekonomi, infrastrukturë, aktivitete kulturore, peshkim, ,etj.

¹ Konventa Evropiane për vetëqeverisje lokale (*European Charter on Local Self-menagment*) Neni 9. Kjo Konventë është miratuar nga Këshilli i Europës në 15.10.1985 në Strasburg. Hyri në fuqi në 01.09.1988. U nënshkruajt nga 40 shtete dhe u ratifikua nga 37 sosh. Që ky numër të jetë në rritje e sipër, konventa në fjalë parasheh parimet që duhet të respektohen nga të gjithë sistemet demokratike në nivel lokal, ashtu që ka një ndikim të madh, në zhvillimin e vetëqeverisjes lokale dhe demokracisë në Europë.

Metodat hulumtuese dhe teknike

Hulumtimi në fjalë ka një peshë të veçantë dhe duhet të plotësojë nivelin e duhur, prandaj do të përdoren metodat: historike, sociologjike, krahasuese. Gjithashtu gjatë këtij hulumtimi do të përdoren një numër i teksteve Universitare të autorëve të ndryshëm si nga vendi ashtu edhe autoreve ndërkombëtarë, konventa ndërkombëtare, Kushtetuta dhe Ligjet që i referohen kësaj fushe, punime të botuara nga autore të ndryshëm lidhur me bashkëpunimin ndërkufitar etj.

Hipotezat

Nga studimet dhe rezultatet që do të arrihen gjatë këtij hulumtimi do të dalin hipotezat se cilët janë faktorë që mundësojnë bashkëpunimin ndërkufitar të Komunës së Strugës dhe Pogradecit si dhe zhvillimin, organizimit dhe funksionimit e këtyre komunave. Poashtu në të njëjtën kohë do të theksojmë faktorët që do të përmirësojnë organizimin dhe funksionimin e Komunës së Strugës dhe Pogradecit në disa fusha të caktuara.

KAPITULLI I PARË

1. Të dhënat teorike mbi qeverisjen lokale

1.1 Nocioni

Qeverisja lokale ka kuptime të ndryshme në gjuhë të ndryshme . Edhe në Gjuhën Shqipe e hasim si: Pushtet vendor (Shqiperi), Vetadministrim Lokal (Kosovë), Vetëqeverisje Lokale (Maqedoni), Pushtet Lokal etj. Por si më i përshtatshëm perdoret termi Qeverisje Lokale.

Ne Gjuhen Angleze perdoret termi Local Government (ne literaturen angleze perdoret termi Self Local Government) Veteqeverisje Lokale, Ne SHBA perdoret termi Local Government (Pushtet Lokal), ne France perdoret termi L'administration Locale (Administrata Lokale), ne Gjermani Local Selbstverwaltung (Veteqeverisje Lokale), ne Kroaci Lokalna Uprava (Qeverisje Lokale), ne Bullgari Mesnoe Samoupravljenje (Veteqeverisje Lokale), ne Maqedoni Lokalna Samouprava (Veteqeverisje Lokale).

1.2 Përkufizimi

Lidhur me përkufizimin e qeverisjes lokale mund të themi se janë marrë shumë teoreticiante nga shume vende të botës dhe atë qysh me zanafillat e para të qeverisjes lokale dhe deri me sot. Mendimet e teoreticienteve janë të ndryshme mvarësisht edhe nga koha se kur ato paraqiten. Ne do të përmendim disa nga autorët si:

Këto përkufizime edhe pse kanë ndryshime në mes vedi si tërësi ruajnë elemente të përbashkëta që na mundesojnë që qeverisjen lokale ta përkufizojmë në elementet më të rëndësishëm të saj sic janë :

- *territori i kufizuar ,*
- *numri i caktuar i popullatës,*
- *organizimi dhe funksionimi në mënyrë të drejtëpërdrejtë ose përmes përfaqësuesve,*
- *nevojat me karakter lokal.*

Si një ndër përkufizimet më të plota kam përshtypjen se është edhe përkufizimi profesorëve të Nderuar Esat Stavileci – Agni Aliu, të cilët theksojnë se Qeverisja Lokale është një formë e ushtrimit të pushtetit në një territor të kufizuar në bazë të kufijve katastral ku jetojnë një popull i caktuar, të organizuar që në mënyrë të drejtëpërdrejtë ose përmes përfaqësuesve të zgjedhur nga vetë ata t'i realizojnë interesat e tyre me karakter

lokal. Pra, sipas ktij përkufizimi Qeverisja Lokale është vendi ku qytetarët në mënyrë të pavarur i realizojnë interesat me karakter lokal².

1.3 Rëndësia dhe zhvillimi

Rëndësia e Qeverisjes Lokale është e madhe dhe jo rastesisht llogaritet si një ndër fushat më të rëndësishme bashkë me teknologjine informative, administrimin e biznesit, mbrojtjen e mjedisit jetesor , zhvillimin e turizmit, etj. Qeverisja lokale në sisteme të ndryshme nuk ka pozitë dhe rëndësi të njëjtë, që do të thotë se ekzistojnë dallime në statusin dhe shkallën e qeverisjes së njësive të pushtetit lokal, të cilat vërehen edhe në përkufizimin e kuptimit të Qeverisjes Lokale. Organizimit dhe funksionimit të Qeverisjes Lokale duhet t'i kushtohet vemendje e posacme për shkak se ajo duhet te ju mundësojë qytetareve një mirëqenie duke u ofruar shërbime efikase dhe cilësore për realizimin e nevojave me karakter lokal.

Për të pasur një trend të mirë të zhvillimit të Qeverisjes Lokale duhet të kemi parasysh disa faktore si:

- *Sistem politik demokratik,*
- *Finansim të mjaftueshëm,*
- *Pesonel administraiv të kualifikuar,*
- *Mjete bashkëkohore të Teknologjisë Informative,*
- *Resurse natyrore , etj.*

Klima e krijuar dhe menaxhimi i mirëfillte do të na mundësojë jo vetem ruajtjen e standardeve por edhe ngritjen e tyre.

² Aliu Agni, Stavileci Esat; Qeverisja Lokale, Tetovë – Prishtinë , 2009 faqe12.

2. Karakteristikat themelore të Qeverisjes lokale

2.1 Qeverisja lokale dhe demokracia

Një ndër karakteristikat themelore të Qeverisjes Lokale është raporti në mes Qeverisjes lokale dhe Demokracisë³. Këto dy nocione janë trajtuar nga teoreticientë të ndryshëm bile disa mendojnë së janë identike por në të vertetëkëto janë nocione që kanë pika të përbashkëta por që ndryshojnë nga njeri tjetri. Demokracia si nocion nënkupton ushtrimin e pushtetit nga ana e shumicës dhe atë si demokraci përfaqësuese, ku populli përfaqësohet përmes të zgjedhurve të tyre dhe në mënyrë të drejtëpërdrejtë kur populli vendos për çështje të rëndësishme përmes formave të drejtëpërdrejta demokratike si:

- *plebisciti,*
- *iniciativa e lirë dhe*
- *referendumi.*

Ndërsa Qeverisja Lokale është forma e organizimit të pushtetit lokal ku përmes përfaqësuesve në mënyrë të tërthortë ose nëpërmjet të drejtëpërdrejtë realizojnë të drejtat me karakter lokal⁴.

2.2 Qeverisja lokale si kategori e sistemit politik

Për t'u zhvilluar Qeverisja Lokale duhet të ketë mbështetje në dispozitat juridike që nënkupton përfshirjen e saj jo vetëm në Konventën Evropiane për Qeverisje Lokale (Neni 2) por edhe përfshirjen e saj në Kushtetutën e R.M-së (Neni 114, 115, 116, 117) si dhe me Ligjin mbi Qeverisjen Lokale (Shkup 1995).

Të pasurit e një baze juridike të mirëfilltë Ju mundëson qytetarëve realizimin e Qeverisjes Lokale sipas përfshirjes së saj në keto dispozita juridike.

³ Arsim Bajrami: Teoria dhe praktika parlamentare , Prishtine 2002, faqe 26

⁴ Etem Aziri: Sociologjia, Tetove,2007 faqe 74

2.3 Qeverisja lokale si e drejtë e qytetarëve për të marrë pjesë në mënyrë të drejtëpërdrejtë ose përmes përfaqësuesve të vet në zgjidhjen e çështjeve me karakter lokal

Kur kemi parasysh faktin se Qeverisja Lokale është vendi ku qytetarët i realizojnë të drejtat e tyre në mënyrë të pavarur përmes përfaqësuesve të tyre duhet të theksojmë se kjo bëhet në dy mënyra dhe atë:

- *e para - përfaqësuesit e qytetarëve zgjidhen në zgjedhjet lokale demokratike*
- *e dyta – qytetarët janë pjesëmarrës të drejtëpërdrejtë në realizimin e interesave me karakter lokal.*

Qytetarët kanë të drejtën aktive (e drejta për të zgjedhur përfaqësuesit e vetë gjatë votimit dhe e drejta pasive e drejta për të qënë kandidat i mundshëm për anëtar të Këshillit të Komunës, Kandidat për Kryetar Komune përkatësisht Anëtar i Këshillit të Qytetit të Shkupit, Kryetar i Qytetit të Shkupit.

Përfaqësuesit e organeve të pushtetit lokal zgjidhen në afatin prej 4 vitesh .

Format e pjesëmarrjes së drejtëpërdrejtë të qytetarëve për zgjedhjen e problemeve me karakter lokal janë: *Tubimi i qytetarëve, Iniciativa e lirë e qytetarëve dhe Referendumi.*

2.4 Qeverisja lokale dhe finansimi i saj

Finansimi i Qeverisjes Lokale paraqet një ndër faktorët themelore për zhvillimin e saj. Jo më kot me këtë problematikë merren një numër i konsiderueshëm i shkencetarëve të kësaj fushe. Finansimi i Qeverisjes Lokale është një çështje e rëndësishme për shkak se pa mjete financiare është e vështirë të organizohet dhe të funksionojë Qeverisja Lokale.

Kjo karakteristikë përfshihet me Kartën Evropiane për Qeverisje Lokale – 1985, Strasburg. Me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë⁵.

Dallohen dy burime financiare të Qeverisjes Lokale:

- 1. Burimet vetanake (Burime që akumulohen mbrenda Qeverisjes Lokale)***
- 2. Burimet nga buxheti i Republikës së Maqedonisë (Hua dhe Kredi).***

Si burime tjera kemi edhe Burimet nga bashkëpunimi i Qeverisjes Lokale me organizatat dhe fondet ndërkombëtare.

⁵ Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë, Shkup, 1991, Neni 115,

2.5.Qeverisja lokale dhe fushëveprimi i saj

Gjithashtu edhe fushëveprimi i Qeverisjes Lokale luan një rol të rëndësishëm për arsye se mundëson ndarjen e kompetencave në mënyrë sa më të drejtë. Kompetencat e Qeverisjes Lokale ndahen në dy grupe themelore dhe atë në:

- **Kompetenca të pavarura dhe**
- **Kompetenca të deleguara**

Kompetencat e pavarura janë kompetenca të cilat janë të parashikuara edhe me Ligjin mbi Qeverisjen Lokale si punë të organeve të pushtetit lokal. Këto punë organet e pushtetit lokal duhet ti kryejnë në mënyrë të pavarur duke mos i dhënë llogari askuj për punët e veta. Llogari duhet të japin vetëm për shkeljen e Ligjshmërisë dhe Kushtetutshmërisë. Ndërsa tek punët e deleguara nga ana e pushtetit qendror , gjë që zakonisht ndodh kur pushteti qendror ka një volum të madh të punëve atëherë ai bën delegimin e punëve për t'u kthyer ato më shpejtë⁶.

Organet e pushtetit lokal mund ti kryejnë ato pa të drejtë të vendimmarrjes dhe tu japin llogari të përgjithëshme për punën e tyre si dhe për Ligjshmërinë dhe Kushtetutshmërinë para Organeve Qendrore.

2.6 Qeverisja lokale dhe ndarja territoriale

Ndarja territoriale gjithashtu është një ndër karakteristikat themelore të Qeverisjes Lokale. Para se të bëhet ndarja territoriale duhet pasur parasysh disa faktorë si: sipërfaqja e territorit të bashkësisë lokale, numri i popullatës, kufijtë e interesit lokal, lloji dhe volumi i profesioneve, me ushtrimin e të cilëve plotësohen ato nevoja.

Duhet pasur parasysh homogjenitetin, gravitimin kah disa institucione të rëndësishme (spitalet, shkollat, universiteti dhe kapacitetet ekonomike financiare të vetëqeverisjes lokale).

Ndarja territoriale bëhet me akt shtetëror ose me ligj, por paraprakisht konsultohet popullata lokale. Kjo është metoda sipas Kartës Evropiane të Vetëqeverisjes Lokale ku thuhet se ***“kufijtë e njësive të vetëqeverisjes lokale nuk mund të ndryshohen pa konsultim paraprak të bashkësive lokale”***.

⁶ Siljanovska D.G.; Mitkov, V.: Lokalna samoprava, Shkup, 2000, faqe 20 – 22.

Lidhur me orgaizimin e administratës si dhe burimet e mjeteve për kryerjen e punëve të pushtetit lokal “ Karta Evropiane e vetëqeverisjes lokale” u garanton njësive lokale të drejtën për organe të veta dhe kuadrin e punësuar në to. Pushteti lokal ka të drejtë ta rregullojë strukturën e brendshme dhe ta aftësojë për nevojat lokale që të ketë udhëheqje efikase.

Kushtet e punës së të punësuarve në pushtetin lokal duhet të jenë ashtu që të mundësojnë punësim të kuadrit kualitativ profesional.

Karta Evropiane e Vetëqeverisjes Lokale lidhur me kushtet e punës thekson se duhet të vlejnë disa rregulla. Në fillim kushtet e punës së funksionarëve komunalë duhet të jenë të atilla që të mundësojnë kryerjen e funksioneve si dhe shpërblimin përkatës së bashku me sigurimin. Të gjitha funksionet që duhet t’i kryejnë, duhet të jenë të parapara me kushtetutë dhe ligj.

2.7 Qeverisja lokale dhe bashkëpunimi i saj

Bashkëpunimi i Qeverisjes Lokale është një karakteristike e rëndësishme që ndikon në mënyrë të drejtëpërdrejte në zhvillimin e saj në fusha të caktuara.

Pra, lidhja e marrëveshjeve të njësive të vetëqeverisjes lokale mes vedi në kuadër të shtetit apo edhe me njësi të vetëqeverisjes lokale ndërkombëtare ndikon në zhvillimin e vetëqeverisjes lokale.

Duhet theksuar se mund të bëhet binjakëzimi në mes të njësive lokale të të njejtit shtet si dhe i njësive lokale të shteteve të ndryshme.

Në “Kartën Evropiane për Vetëqeverisje Lokale“ lidhur me bashkimin e njësive lokale theksohet se organet vendore gjatë ushtrimit të funksioneve të veta kanë të drejtë si rezultat i pavarësisë të bashkpunojnë me organe të njësive lokale tjera në kuadër, të parashikimit ligjor për të kryer disa punë me interes të përbashkët⁷.

Gjithashtu pushteti lokal ka të drejtë ashtu si është paraparë me ligje, të bashkëpunojë me pushtete lokale gjegjëse të një shteti tjetër.

Po ashtu Qeverisja Lokale mund të bashkëpunojë me organizatat ndërkombëtare sidomos atë të nivelit lokal si dhe me fondet ndërkombetare.

⁷ Karta Evropiane për Vetëqeverisje Lokale, Strazburg 1985, Neni 9.

2.8 Raporti i organeve të pushtetit lokal me organet e pushtetit qendror

Edhe raporti i organeve të pushtetit lokal dhe atij qendror luan një rol të rëndësishëm në zhvillimin, organizimin dhe funksionimin e Qeverisjes Lokale.

Është e rëndësishme që përmes dispozitave juridike të përcaktohet në mënyrë sa më të drejtë kufiri i kompetencave në mes të organeve të pushtetit qendror dhe atij lokal, gjë që do të mundësonte një bashkëpunim të mirëfilltë në mes tyre⁸.

Një pjesë të punëve organet e Pushtetit Lokal duhet t'i kryejnë në mënyrë të pavarur, ndërsa një pjesë tjetër në bashkëpunim me organet e pushtetit qendror dhe një pjese tjetër janë punët e deleguara nga ana e Pushtetit Qendror.

- ***Punët e pavarura ndryshe mund ti quajmë si punë të decentralizuara.***
- ***Punët e përbashkëta si punë konkrete ,ndërsa***
- ***Punët e deleguara si punë të dekoncentruara.***

Bashkëpunimi i mirëfilltë i organeve të pushtetit qendror dhe atij lokal ndikon në mënyrë të drejtpërdrejtë në zhvillimin e Qeverisjes Lokale.

2.9 Qeverisja lokale dhe mbrojtja juridike

Sa i përket mbrojtjes juridike në Kartën Evropiane të Qeverisjes Lokale theksohet se “***organet vendore duhet të gëzojnë mjete juridike për ushtrimin e lirë të funksioneve dhe të respektimit të parimeve të parapara me kushtetutë apo me ligj të shtetit të vet***”.

Pra mbrojtje ligjore duhet të sigurojë shteti⁹. Shtrohet pyetja si e bën shteti mbrojtjen ligjore ? Ajo arrihet në procedurat e gjykatave të rregullta, të gjykatave kushtetuese të veçanta ose gjykatave administrative varësisht si është e rregulluar mbrojtja ligjore në shtetet përkatëse.

Në botën bashkëkohore në aspektin teorik vlerësohet se ka më shumë shtete, në të cilat vetëqeverisja lokale vihet në plan të dytë në raport me shtetin dhe pushtetin shtetëror, i cili e merr mbi vete rregullimin e disa çështjeve të rëndësishme për ekzistencën e qytetarëve.

Arsyet janë të ndryshme, por si më të rëndësishme theksohen:

1. Zgjerimi i rolit të shtetit bashkëkohor, forcimi i centralizmit dhe etatizmit.
2. Formimi i shumë partive politike, të cilat nuk shfaqin interesim për politikën lokale.
3. Kalimi i shumë punëve të cilat më parë kryheshin nga ana e pushtetit vendor në kompetenca të pushtetit shtetëror.

⁸ Ligji i Veteqeverisjes Lokale ne R. e Maqedonise, Shkup, 2001, Neni 78.

⁹ Ligji i Veteqeverisjes Lokale ne R. e Maqedonise, Shkup, 2001, Neni 85.

4. Ngushtimi i pavarësisë financiare të Qeverisjes lokale, e cila varsohet nga donacionet dhe subvencionet e shtetit.
5. Ngushtimi i pavarësisë së Qeverisjes lokale nga aspekti normativ.
6. Zvogëlimin e hapësirës së Qeverisjes lokale për nevojat e punëve publike të veçanta (shëndetësia, arsimi, komunikacioni etj.).

Këto janë disa veti të shteteve ku Qeverisja Lokale ka mbështetje të vogël por nga ana tjetër ekziston edhe taborri i shteteve ku Qeverisja Lokale ka një rëndësi të veçantë. Ato bëjnë fjalë për një Qeverisje Lokale demokratike të vërtetë. Një rol të rëndësishëm për zhvillimin e vetëqeverisjes lokale luan “Karta Evropiane e Qeverisjes Lokale“. Prej aty janë vërtetuar dhe përpunuar elementet më të rëndësishëm të statusit të vetëqeverisjes lokale që jep një kontribut lidhur me unifikimin e përmbajtjes së vetëqeverisjes lokale në disa shtete të caktuara të Evropës, që e bënë edhe internacionalizimin e vetëqeverisjes lokale.

KAPITULLI I DYTË

3. Bashkëpunimi nderkufitar dhe rajonal

3.1 Bashkëpunimi i brendshëm i komunave

Bashkëpunimi i Qeverisjes Lokale është çështje e rëndësishme prandaj edhe është përfshirë me Konventën Evropiane për Qeverisje Lokale neni 10 , pastaj me Kushtetutën e R.M-së, Ligjin mbi Vetëqeverisjen Lokale të R.M-së si dhe me Statutin e Komunave¹⁰.

Në rend të parë vëmendje e posaçme i kushtohet bashkëpunimit të komunave mbrenda shtetit dhe në të gjitha dispozitat juridike përfshihet ky bashkëpunim. Komunat ndërmjet vedi mund të bashkëpunojnë në të gjitha fushat ku ato kanë interes e përbashkëta si psh: urbanizmi, mbrojtja e ambientit jetësor, veprimtari të ndryshme ekonomike, turizëm, shkencë, arsim, kulturë, sport, komunikacion, etj.

Për bashkëpunimin mes komunave mbrenda shtetit vendos Këshilli i Komunave, përkatësisht Këshilli i Qytetit të Shkupit¹¹.

3.2 Bashkëpunimi ndërkombëtar i komunave

Ligji mbi Vetëqeverisjen Lokale parasheh edhe bashkëpunimin ndërkombëtar të komunave në nivel lokal. Bashkëpunimi i komunave tona me komuna të shteteve tjera quhet Binjakëzim ose Vëllazërim . Për bashkëpunimin e komunave të binjakëzuara vendos Këshilli Komunal. Bëhen memorandum bashkëpunimi në fusha të ndryshme si në: urbanizëm, mbrojtje të ambientit jetësor, veprimtari të ndryshme ekonomike, turizëm, shkencë, arsim, kulturë, sport, komunikacion, si dhe projekte të përbashkëta për ndërtimin e hidrocentraleve, urave, hekurudhave, autostrada, etj.

Komunave gjithashtu u lejoheq që të anëtarësohen në organizata të nivelit lokal siç është NALAS-I, dhe të marrin pjesë në projekte të përbashkëta me interes për komunat e ndryshme.

3.3 Bashkëpunimi i komunave me organizata ndërkombëtare

Bashkëpunimi ndërkombëtar i komunave bëhet është përfshirë me Ligjin mbi Qeverisjen Lokale . Bashkëpunimi bëhet me Organizatat ndërkombëtare, të cilat janë institucione që

¹⁰ Ligji mbi Vetëqeverisjen Lokale ne R. e Maqedonise, Shkup 2001, Neni 78.

¹¹ Po aty.

formojnë anëtarësime dhe bashkëpunime të paktën nga tre shtete, të cilat kanë aktivitete dhe programe të ndryshme në shtete të tjera.

Krijimi i tyre lindi si rezultat i nevojës së paqes dhe i marrëdhënieve miqësore në botë, i nevojës së ndryshimit të politikës në disa shtete të botës, mbatjes së ekonomisë të qëndrueshme dhe i nevojës së bashkëpunimit dhe këmbimit të eksperiencës mes shteteve me qëllim të avancimit në mënyrën e administrimit të sistemit të shtetit në tërësi.

ON ndahen në dy lloje dhe atë:

- ***në organizata ndërkombëtare jo-qeveritare dhe***
- ***organizata ndërkombëtare qeveritare.***

ON jo-qeveritare operojnë në gjithë botën ku ndër më të njohurat janë Komiteti Ndërkombëtar i Kruqit të Kuq dhe Organizata Botërore e Lëvizjes Zbuluese, ndërsa ON qeveritare janë lloje të organizatave të cilat më afër janë lidhur me termin “organizata ndërkombëtare” të ndërtuara nga shtetet anëtare ku më të njohur janë: Organizata Për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE), Këshilli i Evropës (KE) Unioni Evropian (UE) dhe Organizata Tregtare Botërore (OTB).

Të gjitha këto ON janë mekanizma të cilat synojnë ndërtimin e shprehive të bashkëpunimit dhe mirëbesimit me qëllim që të rritet pamvarësia ekonomike, të zvogëlohen problemet politike, të krijohen marrëdhënie më të shumta me shtetet e botës, me çka shtetet do të kishin më lehtë tejkalimin e problemeve me të cilat ato ballafaqohen.

Një ndër ON më të zhvilluar në këtë aspekt është Unioni Evropian, i cili ndryshe është i njohur si Organizatë Supranacionale sepse paraqet aspirata tek shtetet të cilët dëshirojnë të bëhen anëtarë të Unionit Evropian, gjegjësisht pjesë e familjes së madhe Europiane.

Gjithashtu lejohet edhe bashkëpunimi i Komunave me fondet ndërkombëtare si: IPA, PHARE, USAID, etj.

3.4 Anëtarësimi i komunave në asociacionet ndërkombëtare me karakter lokal

Perpjekjet e qeverisjes lokale për t'i përmbushur nevojat e qytetarëve ka sjellur që organizatat dhe asociacionet e ndryshme në nivelin lokal, ndërkombëtar, regional dhe botëror të bashkëpunojnë midis veti për të arritur realizimin efektiv të programeve dhe punëve të ndryshme me interesa të përbashkëta.

Në këtë frymë KEV gjithnjë e ka vlerësuar këtë çështje si një nga çështjet më të rëndësishme për sigurimin e shërbimeve publike dhe mbrojtjen e mjedisit, prandaj më 17 janar të vitit 1994, krijoi Kongresin e Autoriteteve Lokale dhe Rajonale të Evropës, kurse në vitin 1957

ndërmori hapin e parë në prezantimin e qeverisjes lokale dhe prej atëherë veprimtaria e këtij kongresi është zgjeruar nga Islanda deri në ish Federatën Ruse dhe nga Norvegjia e deri në Ballkan.

Asambleja e Rajoneve Europiane (AER)- u krijua në vitin 1985 duke qënë rrjeti më i pamvarur i autoriteteve rajonale në Evropë edhe më gjërë, duke sjellë sëbashku rreth 270 rajone nga 33 vende, sëbashku me 16 organizata ndër rajonale. Ajo përfaqëson organizatën më të madhe në të gjithë Evropën për bashkëpunim midis rajoneve.

AER-ja përmes disa misionëve që i ka përkrah konceptin e demokracisë rajonale në Europë, përkrah interesat e qeverisjes rajonale në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, përkrah dhe mbështet zhvillimin e drejtimit të qeverisjes rajonale, për të zhvilluar aftësinë e rajoneve për ta bërë Europën sa më parë qytetarëve dhe për të mbështetur bashkëpunimin rajonal në Europë.

Kongresi i Autoriteteve Lokale dhe Rajonale të Evropës (CLRAE) – është një Asamble Politike Evropiane me 636 anëtarë të cilat mbajnë një zyrë zgjedhore, duke përfaqësuar kështu mbi 200.000 autoritete lokale në 47 shtete të Evropës.

Roli i saj është të promovojë demokraci rajonale dhe demokratike, të përmirësoj qeverisjen lokale dhe qëndrore dhe të përforcojë autoritetet e vetëqeverisjes lokale. Rëndësi të veçantë i përkushton aplikimit të principeve të shkruara në Kartën Europiane për Vetëqeverisje Lokale. Detyrat e saj observuese zgjerojnë të gjithë procesin zgjedhor me monitorimin e saj të KEVL. Kongresi luan një rol aktiv në projekte të ndryshme me qëllim të përforcimit të demokracisë lokale dhe bashkëpunimit në Europë dhe inkurajon vendosjen e asociacioneve ndërkombëtare të autoriteteve lokale dhe rajonale, Agjenci Lokale Demokratike dhe një formë të re të Euroregjionit.

3.5 Anëtarësimi i komunave në asociacionet rajonale

Anëtarësimi i njësive të qeverisjes lokale në asociacionet rajonale ofron një mundësi për shetetet anëtare të secilit asociacion rajonal të ndajë njohuri dhe ide me qëllim që të analizojnë më mirë problemet e përbashkëta me të cilat ato ballafaqohen.

Egzistojnë një numër i madh i asociacioneve rajonale ku më të njohurat janë: Rrjeti i Qyteteve të Evropës, Rrjeti European i Organizatave të Trajnimit për Autoritetet Lokale dhe

Rajonale, Unioni i kryeqyteteve të Europës Qëndrore dhe Juglindore, Asociacioni i Agjencive të Demokracisë Lokale, Rrjeta e Shoqatave Nalas dhe të tjerë¹².

Rrjeti i qyteteve të Europës (Eurotoëns) – është themeluar në vitin 1991 si një rrjet më i gjërë në Evropë për qytetet me popullsi prej 50.000 deri më 250.000. Qytetet të një madhësie të tillë luajnë një rol të rëndësishëm në jetën shoqërore dhe ekonomike të Evropës.

Rrjeti i qyteteve të Europës (Eurocities) – është një rrjet i qyteteve më të mëdha Evropiane. Anëtarët e saj janë qeveritë e zgjedhura lokale dhe komuanle të qyteteve të mëdha të Evropës. Ky rrjet u themelua në vitin 1986 nga qytetet e mëdha si Barcelona, Birmingham, Frankfurt, Lion, Milan dhe Rotterdam.

Unioni i kryeqyteteve të Europës Qëndrore dhe Juglindore (The Union of Central and Southeastern European Capitals UCSEEC)- në vitin 1995 qyteti i Athinës mori iniciativën të themelojë një Konferencë Permanente të kryeqyteteve të Mëdha të Europës Juglindore nga Vienna deri në Nikosi. Në shtator të vitit 2002, pas një vendimi të rëndësishëm të bërë në Lubljanë, për të zëvendësuar konferencën e mëparshme u transformua në Bashkimin e Kryeqyteteve të Europës Qëndrore dhe Juglindore, duke u zgjeruar dhe duke përfshirë Kryeqytete të Europës Lindore. Unioni i kryeqyteteve Qëndrore dhe Juglindore Evropiane është një organizatë ndërkombëtare ku anëtarë janë qytetet Athina, Beogradi, Bratislava, Bukureshti, Budapesti, Kievi, Lubljana, Nikosia, Podgorica, Sarajeva, Shkupi, Sofja, Tirana, Viena dhe Zagrebi.

Rrjeti European i Organizatave të Trajnimit për Autoritetet Lokale dhe Rajonale (ENTO) – është një rrjet i cili përbëhet pothuajse nga të gjithë 47 anëtarë të Këshillit të Europës. Ky rrjet është një “fëmijë” e Këshillit të Europës ndonëse u zhvillua si një organizatë e pamvarur në Janar të vitit 1995 në Francë. Është një organizatë jo-profitabile e finansuar nga sponsorimet e disa shteteve anëtarë të saj si dhe nga Këshilli i Europës. Aktualisht qendra e saj ndodhet në Strasburg ku synimi kryesor qëndron në promovimin e qeverisjes demokratike dhe efektive duke dhënë ndihmë me ekspertë dhe trajnim për vendet e Evropës Qëndrore dhe Lindore.

Asociacionet e Autoriteteve Lokale si Rrjetin e Asociacionve të Autoriteteve Lokale në Europën Juglindore NALAS, dhe Asociacionin E Njësisë të Qeverisjes Lokale të Republikës së Maqedonisë ZELS. Financohet nga Komisioni European, Këshilli i Evropës dhe një numër i madh i donatorëve publik dhe privat. ALDA fokusohet në tema të ndryshme siç janë: Integrimi Evropian, përfshirja e të rinjve, të drejtat e njeriut, imigrimi, mundësi të barabarta,

¹² Agni Aliu, Disertacioni I Doktoratures, Procesi I decentralizimit pas marreveshjes kornize të Ohrit, Tetovë, 2008, faqe 120.

zhvillimi të qëndrueshëm ekonomik, decentralizimi dhe vullnetarizimi. Punon më së shumti në shtetet anëtarë të Unionit Evropian dhe shteteve Evropiane fqinje.

Rrjeta e Shoqatave NALAS- është një rrjet i asociacioneve të autoriteteve lokale të Evropës Juglindore. Rrjeti sjell më afër tyre 15 asociacione të cilët përfaqësojnë përafërsisht 4000 autoritete lokale, direkte të zgjedhura nga më shumë se 80 million banorë të këtij rajoni. NALAS u krijua në vitin 2001 pas mbajtjes së forumit të parë të Qyteteve dhe Rajoneve të Europës Juglindore në nëntor të vitit 2001 të organizuar nga Këshilli i Autoriteteve Lokale dhe Rajonale të Këshillit të Evropës.

Gjatë viteve të para, Nalas funksiononte si një organizatë jo formale me mbledhje, seminare dhe programe trajnuese të rregullta. Në korrik të vitit 2005 rrjeti NALAS u bë një shoqatë e regjistruar zyrtarisht me seli në Strasburg.

NALAS promovon procesin e decentralizimit në bashkëpunim me qeveritë qendrore dhe organizatat ndërkombëtare, duke konsideruar vetëqeverisjen lokale si një çelës kryesor në procesin e tranzicionit në vendet e Evropës Juglindore.

3.6 Anëtarësimi në komunave asociacionet ballkanike

Asociani Ballkanik që mundëson anëtarësimin dhe bashkëpunimin e komunave ballkanike është **Rrjeti Qytetet e Ballkanit-Balcinet (Balcinet-Balkan Cities Network)**, i cili është themeluar në qytetin e Selanikut në dhjetor të vitit 2001, ku të anëtarësuar janë 32 qytete nga 8 shtete ballkanike midis të cilëve 8 prej tyre janë kryeqytete. Republika e Maqedonisë poashtu është e përfshirë në këtë rrjet me tre qytetet e saja më të mëdha si Shkupi, Tetova dhe Kumanova.

Fushat në të cilat zhvillohen bashkëpunime në këtë rrjet janë vetëqeverisja lokale, mjedisi, infrastruktura, zhvillimi urban, arsimi, transporti, zhvillimi ekonomik, kulturor dhe social, tregtia, zhvillimi teknologjik, energjia dhe industria, telekomunikacionet dhe informatika.

Qëllimet e këtij Rrjeti ballkanik janë avancimi i marrëdhënieve fqinjësore përmes bashkëpunimeve kulturore, ekonomike dhe bashkëpunimit ndër universitar si dhe qasjen në fondet evropiane përmes projeteve të përbashkëta, promovimit të regjionit në botë dhe të çdo qyteti në veçanti, afirmim të vlerave kulturore të përbashkëta dhe specifike si dhe shkëmbimin e përvojave ballkanike. Ky rrjet qytetesh ballkanike synon bashkëpunime në mes shteteve ballkanike që të promovohen paqja dhe miqësia në mes qytetarëve të ballkanit që të arrihen rrezultate në cilësimin e jetës së tyre.

4.Korniza juridike që rregullon bashkëpunimin ndërkufitar

4.1 Konventa Evropiane për Vetëqeverisje Lokale (Self local government charter)

Përpjekjet për të bërë një standardizim të parimeve themelore për organizimin dhe funksionimin e Qeverisjes Lokale u arritën pikërisht me miratimin e Kartes Evropiane për Qeverisje Lokale.

Ajo u miratua në 15 tetor të vitit 1985 në Strasburg nga ana e Keshillit të Evropës. dhe hyn në fuqi në Shtator të Vitit 1988.

Konventa kërkon që principet e qeverisjes lokale të jenë të ndërtuara në kushtetutë me qëllim që të garantohet implementimi i saj efektiv. Ajo paraqet principet e funksionimit demokratik të komunave dhe të transferimit të kompetencave në pushtetet lokale të cilat duhet të jenë të shoqëruara nga resurset financiare. Ky princip i njohur si principi i subsidiaritetit i cili lejon decentralizimin e fuqive më afër popullatës lokale.

Qeverisjet lokale kanë të drejtën e veprimit brenda limitive të ligjit, kanë mundësinë të rregullojnë dhe menaxhojnë punët lokale nën përgjegjësinë e tyre për interesat e qytetarëve lokal. Konventa konsideron përgjegjësitë lokale si detyra që duhet të zhvillohen dhe ushtrohen nga autoritete të cilat janë më afër popullatës¹³.

Qëllimi i KEVL është të arrijë një unitet në mes shteteve antarë të kësaj konvente në realizimin e idealeve dhe principeve të njësive të vetëqeverive lokale sepse pushtetet lokale dhe pjesëmarrja e qytetarëve në çështjet publike janë një nga themelet kryesore të secilit regjim demokratik të ndara nga të gjitha shtetet antare të Këshillit të Evropës.

Konventën e kanë ratifikuar gjithë anëtarët e Keshillit të Evropës dhe numri i ratifikimit po stohet nga dita në ditë. Konventa Evropiane flet në nene të vecanta për bazën juridike të Qeverisjes Lokale, për kompetencat e organeve të pushtetit lokal, për burimet e finansimit, për ndarjen territoriale, për bashkëpunimin e Qeverisjes Lokale, etj.

4.2 Kushtetuta e R së Maqedonise

Kushtetuta e R.M-së paraqet një kushtetutë liberale demokratike e cila u miratua në 17 Nëntor të Vitit 1991 ku përfshihen parimet kryesore të rendit juridik, politik dhe kushtetues. Me kushtetute përfshihen parimet e pergjitheshme të Qeverisjes Lokale¹⁴.

Ajo u kushton rëndësi të veçantë lirive dhe të drejtave të njeriut e të shtetasit, lirisë së tregut dhe sipërmarsisë, sundimit të së drejtës, organizimit horizontal dhe vertikal të pushtetit,

¹³ Konventa Evropiane për Vetëqeverisje Lokale, Strazburg, 1985, Neni 10.

¹⁴ Kushtetuta e R. Maqedonise, Tetove, 2007, Neni 114.

marrëdhënieve të mbrendshme dhe të jashtme të shtetit, dhe një varg vlerash themelore kushtetuese. Një ndër këto vlera është edhe vetadministrimi lokal.

Sipas Kushtetutës, njësi të qeverisjes lokale janë komunat, ku mbrenda komunave mund të formohen njësi më të vogla të qeverisjes lokale.

Komunat janë të pamvarura në ushtrimin e kompetencave të përcaktuara me Kushtetutë dhe me ligj, ndërsa mbikqyrjen mbi ligjshmërinë e punës së saj e bën Qeveria. Përkrahja financiare e komunave bëhet përmes burimeve vetanake të të hyrave të përcaktuara me ligj dhe me mjete nga Buxheti Shtetëror.

Kushtetuta u garanton qytetarëve të drejtën e vetadministrimit lokal si dhe u garanton në njësitë e vetëqeverisjes lokale në mënyrë të drejtëpërdrejtë dhe nëpërmjet përfaqësuesve të vet të marrin pjesë në vendimarrje për çështjet me rëndësi lokale e veçanërisht në fushat e urbanizimit, veprimtarive komunale, kulturës, sportit, mbrojtjes sociale dhe të fëmijëve, edukimit parashkollor, arsimit fillor, dhe në fusha të tjera të përcaktuara me ligj.

Në RM vetëqeverisja lokale sipas kushtetutës nuk është e rregulluar në detaje por mjafton garantimi i të drejtës së saj. Ajo përcaktohet me ligj dhe atë me ligjin mbi qeverisje lokale e cila u soll në vitin 1995 dhe u plotësua në vitin 2002.

4.3 Kushtetuta e R së Shqipërise

Është miratuar në 21 tetor të Vitit 1998 në Tiranë. Kjo kushtetute i kushton vemendje të vecantë duke e përfshirë Qeverisjen Lokale si pjesë e veçantë në nenet: 108, 109, 110, 111, 112, 113, 114, dhe 115.

Sipas Kushtetutës Njësite e Qeverisjes Lokale konsiderohen Komunat ose Bashkitë (shkalla e parë) dhe Qarqet (shkalla e dytë).

Ndarja territoriale – administrative e njësive të qeverisjes lokale bëhet me ligj. Kufijtë e tyre nuk mund të ndryshohen pa konsultim paraprak të banorëve që banojnë në to.

Njësite e qeverisjes lokale janë komuna dhe bashkia. Ato i kryejnë gjithë detyrat që i parashikon ligji. Ato që ligji i parasheh si detyra të njësive tjera nuk janë kompetenca të komunave dhe bashkive.

Qeverisja lokale i ushtron detyrat e veta përmes organeve përfaqësuese dhe përmes pjesëmarrjes së drejtëpërdrejtë të tyre në zgjidhjen e çështjeve me karakter lokal.

Organet përfaqësuese të njësive të qeverisjes lokale janë: këshilli dhe kryetari i komunës ose bashkisë si organ ekzekutiv¹⁵. Zgjedhja bëhet për tre vite në zgjedhjet lokale të drejtëpërdrejta dhe demokratike sipas Ligjit mbi Zgjedhjet Lokale.

Qarku përbëhet nga disa njësi bazë të qeverisjes lokale me lidhje tradicionale, ekonomike – sociale, etj. Ai është njësia ku ndërtohen dhe zbatohen politikat rajonale dhe harmonizohen me politikat e pushtetit shtetëror. Qarku udhëhiqet nga Këshilli i Qarkut, i cili përbëhet nga anëtarët e deleguar nga Komunitetet dhe Bashkitë.

Njësitë e Qeverisjes Lokale janë persona juridik. Ato kanë buxhet të pavarur, krijimi i të cilit parashikohet me ligj.

Njësive të Qeverisjes Lokale mund të ju delegohen punë nga ana e Pushtetit Qendror, për ti kryer ndërsa shpenzimet i siguron shteti.

Punët e pavarura kryejnë Këshillat e Komunës, e Bashkive dhe të Qarkut. Organet e Qeverisjes Lokale mund të nxjerrin Urdhëresa, Vendime dhe Udhëzime.

E Drejta për Qeverisje Lokale mbrohet në Gjykatë.

Prefekti zgjidhet nga Këshilli i Ministrave. Për shkelje të rënda Këshilli i Ministrave mund ta shkarkojë ose ta shpërndajë organin e Pushtetit Lokal. Nëqoftëse organi i shkarkuar apo i shpërndarë nuk është i kënaqur ka të drejtën e ankimit në Gjykatën Kushtetuese.

4.4 Ligji mbi Qeverisjen Lokale të R. së Maqedonisë

Vetëqeverisja lokale sipas kushtetutës së RM-së nuk është e rregulluar në detaje por ajo përcaktohet me ligj të veçantë. Kjo solli ratifikimin e ligjit mbi vetëqeverisje lokale e cila mbështet njësitë e vetëqeverisjes lokale si kategori të sistemit politik. Ligji mbi qeverisjen lokale sëpari u soll në vitin 1995 dhe mandej u plotësua me disa ndryshime në vitin 2002.

Kjo ndodh për arsye se kushtetuta e RM-së si dhe pas ratifikimit të Konvetës Evropiane për vetëqeverisje lokale kërkon që rregullimi i principeve themelore të vetëqeverisjes lokale të bëhen me kushtetutë dhe me ligj të veçantë.

Në ligjin mbi qeverisjen lokale egzistojnë 105 nene të cilat rregullojnë parimet themelore të vetëqeverisjes lokale në RM. Me këtë ligj rregullohen të gjitha detyrat e komunave, pjesëmarrja e drejtëpërdrejtë e qytetarëve në procesin e vendim-marrjes, organizimin dhe punën e organeve të komunës, administratës komunale, aktet e organeve, pronësin e komunës, mbrojtjen juridike, vërtetimin e gjuhëve zyrtare si dhe çështje të tjera lidhur me vetëqeverisjen lokale.

¹⁵ Kushtetuta e R. së Shqipërisë, Tiranë, 1998, Neni 109.

Me këtë ligj poashtu rregullohen edhe bashkëpunimet në mes komunave dhe me njësitë e vetëqeverisjes lokale të shteteve tjera, si dhe me organizatat ndërkombëtare të pushteteve lokale, gjë që sjell avancime në realizimin më pozitiv dhe efektiv të detyrave të tyre.

4.5 Ligji për organizimin dhe funksionimin e Qeverisjes Vendore të R. së Shqipërisë

Ky Ligj është miratuar në Vitin 2000 dhe me këtë ligj është rregulluar në mënyrë të detajuar funksionimi i njësive të Qeverisjes Vendore në Shqipëri si dhe përcaktimi i funksioneve, kompetencave si dhe të drejtave dhe detyrave të tyre¹⁶. Pushteti Vendor ka për qëllim qeverisjen në një nivel sa më afër me qytetarët. Ky është një mision i cili sigurohet me ligj, nëpërmjet njohjes së ekzistencës së identiteteve dhe vlerave të ndryshme si dhe respektimit të të drejtave dhe lirive themelore të shtetasve të sanksionuara me kushtetute ose me ligje të tjera.

4.6 Ligji mbi ndarjen territoriale të R së Maqedonisë

Ndarja territoriale është një nga karakteristikat themelore të qeverisjes lokale që luan rol të rëndësishëm në organizimin dhe funksionimin e vetëqeverisjes lokale. Qka duhet të kemi para se të bëhet një ndarje territoriale. Duhet të mirren parasysh disa faktorë që ndarja të jetë në funksion të vetëqeverisjes lokale dhe atë: sipërfaqja e territorit, numri i popullatës, kufijtë e interesit lokal, lloji dhe volumi i profesioneve, homogjenitetin, gravitimin kah institucionet më të rëndësishme dhe shumë faktorë të tjerë.

Ligji mbi ndarjen territoriale i vitit 1996 solli ndarjen e 123 njësive të vetëqeverisjes lokale dhe qytetin e Shkupit si njësi të veçantë, të cilat u zvogëluan në 85 njësi të vetëqeverisjes lokale (duke përfshirë këtu edhe komunën e Shkupit) me ligjin mbi ndarje territoriale të vitit 2004.

Ligji mbi ndarje territoriale është mjaft i rëndësishëm sepse përcaktohen rregullat në bazë të së cilës bëhet organizimi dhe funksionimi i njësive të vetëqeverisjes lokale si dhe bëhet bashkimi, ndarja dhe ndërrimi i kufijve të komunave. Me ratifikimin e Konventës Evropiane për qeverisje lokale, RM detyrohet që ti përputh të gjitha ligjet e saj për vetëqeverisje lokale me ato të Konventës. Kjo do të ishte mënyra e vetme në zvogëlimin e pakënaqësive tek popullata lokale si dhe mënyra më e mirë në funksionimin e njësive të vetëqeverisjes lokale.

¹⁶Ligji mbi qeverisjen lokale në R.Shqipërisë, 2000

4.7 Ligji mbi ndarjen administrativo - territoriale të R së Shqipërise

Është nxjerrë në Vitin 2000. Si njësi të qeverisjes lokale janë Komuna dhe Bashkia , ndërsa Qarku paraqet një njësi të shkallës së dytë që do të thotë së Qeverisja Lokale në Shqipëri është dy shkallësh.

Komuna paraqet një unitet administrativo – territorial dhe bashkësi banorësh kryesisht nga zonat urbane e në raste të vecanta përfshin edhe zona rurale (fshatra) ndërsa nën ndarjet e Bashkive në zona urbane quhen lagje.

Qytet, shpallet në qendër banimi e cila ka një plan perspektiv të zhvillimit urban.

Qarku paraqet një unitet administrativo – territorial që përbëhet nga disa komuna dhe bashki që kanë një lidhje gjeografike, tradicionale, ekonomike, shoqërore, etj¹⁷.

Qarku ka kufijtë që përputhen me kufijtë e komunave dhe të bashkive që e përbëjnë atë.

4.8 Ligji mbi zgjedhjet lokale të R së Maqedonisë

Ligji mbi zgjedhjet lokale në Republikën e Maqedonisë u soll në korrik të vitit 2004 në Gazetën zyrtare të RM-së. Ligji mbi zgjedhjet lokale përmban 98 nene më të cilat rregullohen procedurat dhe kushtet për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të njësive të vetëqeverisjes lokale, zgjedhjen e Kryetarit të Komunës dhe Kryetarit të qytetit të Shkupit.

Me këtë ligj u garantohet qytetarëve të RM-së e drejta e votimit me zgjedhje të lira dhe direkte në zgjedhjen e anëtarëve të komunave dhe këshillit të qytetit të Shkupit si dhe në zgjedhjen e kryetarëve të komunave dhe kryetarit të qytetit të Shkupit. Të drejtë votimi kanë secili qytetar i Republikës së Maqedonisë i cili ka mbushur moshën 18 vjet¹⁸.

Zgjedhjet bëhen çdo katër vjet, ku organet për organizimin e procesit të zgjedhjeve lokale e kryejnë komisionet zgjedhore të njësive të vetëqeverisjes lokale dhe këshillat zgjedhore. Zgjedhjet duhet të zhvillohen në atmosferë demokratike dhe të lirë, ku secili qytetarë mund të shpreh vullnetin e tij në zgjedhjen e preferencave të tij të kryetarit të komunës apo të shtetit. Mbikqyrja e zgjedhjeve mund të bëhet nga vëzhgues të brendshëm dhe ndërkombëtar, ku komisioni shtetëror sjell kodeksin e rregullave mbi mbikqyrjen e zgjedhjeve sipas standardeve ndërkombëtare.

¹⁷ Kushtetuta e R.Shqipërisë, Tirane, 1998, Neni 110.

¹⁸ Agni Aliu dhe Esat Stavileci , Qeverisja Lokale Njoftime Themelore dhe shqyrtime krahasimtare, Tetove, 2009, faqe 113.

4.9 Ligji mbi zgjedhjet vendore në R e Shqipërisë

Ky Ligj nxirret në Vitin 1992. Përfshin në mënyrë të detajuar mënyrën dhe procedurën e zgjedhjeve të Organeve të Pushtetit Vendor në R. E Shqipërisë. Zgjedhjet janë të drejtëpërdrejta, demokratike, me votim të fshehtë ku zgjidhen anëtarët e këshillit të komunave, bashkive dhe qarqeve si dhe Kryetarët e Komunave dhe Bashkive, ndërsa Kryetari i Qarkut zgjidhet nga Këshilli i Ministrave.

Zgjedhja bëhet cdo tre vite. Gjithashtu përcaktohen edhe shkaqet e ndërprerjes së funksionit të këshilltarëve dhe të kryetarëve.

Organet e pushtetit qendror duhet që të angazhohen maksimalisht për plotësimin e nevojave me karakter lokal.

4.1.1 Ligji mbi finansimin e Qeverisjes lokale të R së Maqedonisë

Financimi i njësive të vetëqeverisjes lokale paraqet një element kyç në organizimin dhe zhvillimin e vetëqeverisjes lokale. Resurset financiare të mjaftueshme sjellin sukses në procesin e vendim-marrjes dhe në realizimin e detyrave, me çka do të arrihen kushte më cilësore në jetën e përditshme të qytetarëve.

Financimi i komunave sipas politikës ekonomike të RM-së bëhet nga burimet vetanake dhe burime të tjera të financimit. Burimet vetanake të komunës janë taksat lokale (tatimi i pasurive të lëna në trashëgim, taksat e tokës komunale, të ardhurat tatimore republikane ose nga jashtë, të ardhurat nga gjobat për mosrespektim të rregullave të njësive të vetëqeverisjes lokale dhe të tjera) të garantuara me ligj¹⁹.

Komunat poashtu financohen nga dotacionet e shtetit dhe burime të tjera të të ardhurave të cilat janë të vërtetuara me ligj.

Njësitet e vetëqeverisjes lokale gjithashtu financohen nga mjete plotësuese nga buxheti i Republikës dhe nga të ardhurat e tjera në formë të huasë nga buxheti i Republikës. Kjo bëhet për arsye të funksionimit të pandërprerë të njësive të vetëqeverisjes lokale, me qëllim që të arrihet efikasitet më i madh në punën e tyre. Një rol të rëndësishëm në financimin e njësive të vetëqeverisjes lokale kanë luajtur organizatat ndërkombëtare si PHARE, USAID, etj, të cilat me mjetet e tyre financiare kanë ndihmuar në realizimin e një numri të madh të projekteve të shtetit.

¹⁹ Ligji mbi finansimin e njësive të vetëqeverisjes lokale, Shkup, 2005, Neni 15.

4.1.2 Ligji mbi finansimin e Qeverisjes Vendore të R së Shqipërisë

Sipas ligjit për finansimin e Qeverisjes Vendore në Shqipëri Njësitet e Qeverisjes Lokale kanë dy llojë burimesh financiare dhe atë:

- **Burimet Vetanake (Buxheti i Pavarur) dhe**
- **Burimet nga Buxheti i Shtetit**

Burimet vetanake janë të gjitha ato burime financiare që grumbullohen nga vete njësitet e qeverisjes vendore (tatimet, taksat, qirata, gjobat, etj.). Këto mjete financiare këshilli i njësive të qeverisjes vendore i shpërndan në mënyrë të pavarur dhe nuk i jep llogari askuj përveç në rastet kur shkaktohet ligjshmëria dhe kushtetutshmëria.²⁰ Burimet nga buxheti i shtetit jepen në formë të kredive dhe huave. Këto sipas ligjit janë të përcaktuara si transferta të kushtëzuara dhe përdoren vetëm për qëllimin për të cilin janë dhënë. Njësitet e qeverisjes vendore mund të sigurojnë mjete financiare edhe nga bashkëpunimi i tyre me fondet ndërkombëtare si IPA, USAID, IPARD, PHARE, etj. Dhe nga organizata të ndryshme ndërkombëtare si FAO, MOR, UNICEF, etj.

4.1.3 Ligji për zhvillimin e barabartë rajonal

Ligji mbi zhvillimin e barabartë rajonal u soll në maj të vitit 2007 me qëllim që të rregullohen pabarazitë rajonale në shtet dhe të bëhet një nivelizim i barabartë në të gjithë rajonin e Republikës së Maqedonisë. Me këtë ligj rregullohen qëllimet, parimet dhe bartësit e politikës për nxitjen e zhvillimit të barabartë rajonal, përcjellja dhe vlerësimi i zbatimit të dokumenteve dhe projekteve të planit dhe çështjeve të tjera të lidhura me zhvillimin e barabartë rajonal²¹.

Zhvillimi rajonal është procesi i identifikimit, nxitjes, menaxhimit dhe shfrytëzimit të pontencialeve zhvillimore të rajoneve dhe vendeve të planit, me nevojë specifike zhvillimore çka sjell një zhvillim të qëndrueshëm në tërë territorin e Republikës së Maqedonisë si dhe një ngritje të cilësisë së jetës për të gjithë qytetarët.

Programi për zhvillimin e barabartë rajonal miratohet në periudhë prej pesë vjetësh, dhe atë përpilohet veç e veç për secilin rajon të planit, në pajtim me strategjinë dhe dokumente, programe, për Integrimin e Republikës së Maqedonisë në Unionin Evropian, më çka arrihet zhvillimi më i mirë i njësive të vetëqeverisjes lokale si dhe realizimi i projekteve të ndryshme ndërkombëtare të cilat do të sjellin avancime në aspektin ekonomik dhe politik të shtetit.

²⁰ Kushtetuta e R. së Shqipërisë, Tirane, 1998, Neni 12.

²¹ Ligji për zhvillimin e barabartë rajonal, Shkup, 2007, Neni 1.

Bartësit e politikës për nxitjen e zhvillimit të barabartë rajonal janë: Qeveria e Republikës së Maqedonisë, Këshilli për zhvillimin rajonal të barabartë të Republikës së Maqedonisë, Ministria e Vetadministrimit lokal dhe Këshilli për zhvillimin rajonal të planit të cilat për qëllim kanë rivitalizimin e fshatrave, zhvillimin e rajoneve me nevoja specifike zhvillimore, përkrahjen e bashkëpunimit ndërkomunal të njësive të vetadministrimit lokal dhe shumë qëllime të tjera.

4.1.4 Marrëveshjet bilaterale dhe multilaterale të njësive të qeverisjes lokale

Marrëveshjet bilaterale dhe multilaterale paraqesin elemente fundamentale të funksionimit efektiv të njësive të vetëqeverisjes lokale. Siç përmendëm më lartë bashkëpunimet do të sjellin këmbime të ideve, informatave dhe përvojave të ndryshme të cilat do të lehtësojnë realizimin e punëve dhe projekteve të ndryshme të njësive të vetëqeverisjes lokale^{22, 23}. Marrëveshjet bilaterale paraqesin marrëveshje dypalëshe ndërsa marrëveshjet multilaterale paraqesin marrëveshje në mes pjesëmarrësve, anëtarëve apo më shumë shteteve. Në kuadër të bashkëpunimeve ndërkombëtare shembulli i binjakëzimeve paraqet marrëveshje të mundshme të formës bilaterale kurse shembulli i partneritetit për fitim të projekteve paraqet marrëveshje të formës multilaterale.

Realizimi i këtyre marrëveshjeve bëhet përmes iniciativës të cilët e ndërmarrin këshilltarët komunal, e cila paraprakisht vendoset në rend dite për miratim në mbledhje të këshillit komunal. Në çdo marrëveshje paraqiten palët kontraktuese, të cilat vendosin të bashkëpunojnë për të arritur një qëllim të përbashkët për një afat kohe të caktuar. Lidhja e marrëveshje rregullohet me statut dhe rregullore si akte të brendshme të NJVL të cilat janë statuti dhe rregullorja.

Aplikimi i marrëveshjeve bilaterale dhe multilaterale janë bazë e nevojshme në realizimin e nevojave të qytetarit dhe kjo tani më është shumë e qartë nga shumë shtete. Ideja e zhvillimit të marrëveshjeve të ndryshme bilaterale dhe multilaterale sjell demokraci në shtet, përforcim në konsultime të ndryshme politike, ekonomike, arsimore, kulturore dhe në krijimin e kushteve të ndryshme për bashkëpunim politik dhe ekonomik.

²² Ligji mbi Vetëqeverisjen lokale ne R. e Shqipërisë, Tirane, 2000, Neni 5.

²³ Ligji mbi Vetëqeverisjen lokale ne R. e Maqedonisë, Shkup, 2001, Neni 76.

KAPITULLI I TRETË

5. Komuna e Strugës



Komuna e Strugës shtrihet në pjesën jug-perëndimore të R. Maqedonisë. Selia e komunës gjendet në Qytetin e Strugës. Ajo kufizohet me Komunën e Ohrit, pastaj me një pjesë të bregut të liqenit të Ohrit dhe me vijën kufitare shtetërore me R. të Shqipërinë.

Komuna shtrihet në mes Maleve Jabllanicë (Guri i zi 2259m), Mali i Belicës (1946m) dhe Mokra (1522m) në perëndim, Karaorman (2076m) në veri dhe Komunën e Ohrit²⁴. Me një sipërfaqe prej 483 km² dhe popullatë prej 63376 banorë sipas regjistrimit të Vitit 2004.. Shkalla e nataliteti në vitin 2004 ishte 10,2% (në 1000 banorë), kurse shkalla e mortalitetit të përgjithshëm ishte 7,5 % (në 1000 banorë).

Emri i vjetër i Strugës ka qënë Enhalon (Qyteti i ngjalave) që na bën me dije se Struga është një qytet shumë i vjetër ilir, aty ku ka kaluar edhe *via egnatia* (ruga ekonomike që ka lidh Kontinentin e Evropës me Kontinentin e Azisë). Struga është një qytet multi-etnik me strukturë të popullatës si vijon: ²⁵

Tabela 1 – Paraqitja tabelare e strukturës së popullsisë në Komunën e Strugës

Kombësia	Numri	%
Boshnjakë	103	0.16%
Gjithsej	63376	100%
Maqedonas	18,158	28%
Romë	116	0.18%

²⁴ www.struga.gov.mk

²⁵ Statuti i Komunes së Struges, Struge, 1997.

Serbë	106	0.16%
Shqiptarë	49,559	61,5%
Turq	3628	6%
Të tjerë	2402	4%
Vlleh	656	1%

Komuna e Strugës është një ndër qytetet turistike më të bukura në Gadishullin Ballkanik. Disponon më shumë resurse natyrore si: Liqenin e Ohrit (Liqeni I Dritës), Lumin Drini I Zi, Fushën e Strugës dhe Malet Jabllanica dhe Karaormani.



Fig.1- Derdhja e Lumit Drini I Zi

Mundësi për zhvillimin ekonomik dhe gati të gjitha llojeve të turizmit.

Komuna e Strugës është një ndër njësitet e qeverisjes lokale të R. M-së ku nacionalitetet si: shqiptarë, maqedonas, turq, vlleh, romë etj të cilët në menyrë të drejtëpërdrejtë apo përmes përfaqësuesve të vetë të zgjedhur nga ana e tyre i realizojnë kërkesat e tyre me karakter lokal.

Komuna e Struges bashkëpunon me shumë komuna të tjera, me qëllim të realizimit të detyrave dhe obligimeve ndaj popullatës në nivel lokal si dhe me qëllim të këmbimit të eksperiencave dhe informatave për arritjen e rezultateve sa me cilesore dhe efikase.

5.1 Organizimi dhe funksionimi i Komunës së Strugës

Struga si qytet është turistik dhe turizmi është një ndër sektorët më të rëndësishëm. Struga vizitohet nga turiste të vendit dhe të huaj.

Qyteti i Strugës disponon me një numër të hoteleve dhe pushimoreve me kamp shtëpiza, të cilat mundësojnë vendosjen e shumë turistëve.

Ka disa fabrika dhe një numër të konsiderueshëm të ndërmarrjeve të vogla private.

Në Strugë mbahen një numër manifestimesh kulturore dhe sportive nga pjesëmarrës të ndryshëm nga vendi dhe nga shtetet e tjera të botës me çka realizohen një numër i madh i bashkëpunimeve të cilat bashkëpunime sjellin zhvillim dhe organizim funksional.

Komuna bashkëpunon rregullisht me komunat e tjerë nga shtetet e ndryshme të botës në lidhje me çështje të ndryshme me interes lokal. Këto bashkëpunime të komunës paraqesin funksionimin kualitativ dhe organizimin efikas të njësive të vetëqeverisjes lokale.

Për bashkëpunimin ndërkomunal vendos Këshilli i Komunës me shumicë votash. (Këshilli i Komunës së Strugës përbëhet prej 27 këshilltarëve)²⁶. Ai mund të vendosë për bashkëpunim në të gjitha fushat mbrenda vendit por edhe jashtë vendit (binjakëzimi i komunave). Bashkëpunimi mund të bëhet në fushën e mjedisit jetësor, ekonomisë, kulturës, sportit, turizmit si dhe në të gjitha fushat ku ato kanë interesa të përbashkëta.

Një bashkëpunim të ngushtë Komuna e Strugës ka me Komunën e Pogradecit , që do ta trajtojmë në kapitullin vijues.

²⁶ www.struga.gov.mk

5.2 Ndarja e Komunës nëpër sektore, degë etj

Komuna e Struges është e organizuar në sektorë dhe njësi :

1. Sektori për çështje Juridike - Financiare dhe administrimin e taksave ;

- *Njësia për çështje juridike ;*
- *Njësia për financa dhe buxhet ;*
- *Njësia për administrimin e taksave ;*

2. Sektori për zhvillim administrativ dhe zhvillim të përgjithshëm :

- *Njësia për veprimtari komunale ;*
- *Njësia për administrimin e zhvillimit të teknologjisë kompjuterike;*
- *Njësia për punë të përgjithshme dhe vetëqeverisje vendore ;*

3. Sektori për urbanizëm, mbrojtjen e mjedisit, punë komunale dhe komunikacion :

- *Njësia për urbanizëm ;*
- *Njësia për mbrojtjen e mjedisit jetësor ;*
- *Njësia për punë komunale dhe komunikacion ;*

4. Sektori për mbyqirje inspektuese (inspektorati komunal) .

Në varësi nga kryetari i komunës janë të krijuar edhe:

- *Njësia për revizion të brendshëm*
- *Njësia e kapaciteteve njerëzore ;*
- *Njësia për mbrojtjen nga zjarri²⁷*

²⁷ www.struga.gov.mk

6. Komuna e Pogradecit



Pogradeci ndodhet në juglindje të Republikës së Shqipërisë, është kryeqendra e rrethit të Pogradecit dhe bënë pjesë në qarkun e Korçës. Pogradeci ka një sipërfaqe prej 13 km² dhe shtrihet në bregun jugor të liqenit të Ohrit. Lartësia mbidetare e Pogradecit është 700 metra mbi nivelin e detit në një luginë, e cila rrethohet nga malet në perëndim dhe nga kodra të ulta në jug dhe në lindje.

Pogradeci ka një popullsi prej rreth 20.848 banorë (sipas regjistrimit të popullsisë në vitin 2011) dhe një dendësi të popullsisë prej 2,962 banorë për km².²⁸

Enkelejtët janë fis që kanë jetuar brenda mureve të kalasë së ndërtuar në majë të kodrës pranë qytetit, në pjesën veri-perëndimore të qytetit.

Pogradeci ka një histori të lashtë dhe dokumenta të shumta kulturore, gjeologjike dhe natyrore. Gërmimet arkeologjike në kodrën mbi qytet kanë zbuluar një vendbanim ilir të shekullit V para Krishtit, që i përket fiseve të lashta Desaret dhe mbase Enkelejteve.

Gjatë shekujve në vazhdim njerëzit e fshatit zbritën poshtë në rrëzë të kodrës dhe krijuan qytetin e Pogradecit, përgjatë bregut të Liqenit të Ohrit.

Zbulimet arkeologjike, që konfirmojnë popullimin në këtë rajon, datojnë nga Periudha Neolitike (6000 vjet para Krishtit), me popullsi dhe ndërtime në rritje gjatë periudhave të Bakrit, Bronzit dhe Hekurit. 24 monumente natyrore dhe 36 monumente të kulturës janë zyrtarisht të dokumentuara. Disa nga monumentet më interesante janë:

²⁸ <http://bashkiapogradec.al/>

- Rrënojat e një vendbanimi ilir dhe një kishë Kristiane me mozaikë shumëngjyrësh janë gjetur në fshatin piktoresk të Linit i cili ndodhet në brigjet e Liqenit të Ohrit.
- Rruga Romake Via Egnatia kalon përmes rajonit, nga Ohri, përgjatë fshatrave të Mokrës dhe mbaron në detin Adriatik në Durrës. Ura e Golikut (shek. XVII) ndërtuar mbi Lumin Shkumbin është gjurmë e kësaj rruge të vjetër romake.
- Burime të shumta ujore përfshi Burimet e Drilonit ku uji i pastër dhe i kristaltë rrjedh në Lumin Drini i Zi.

Pogradeci në të kaluarën ka qenë një qendër e rëndësishme industriale në Shqipëri. Për tu përmendur në atë kohë janë industria e kromit, e hekurit, e nikelit, e qymyrit, e peshki Plazhi e Pogradecit ndodhet brenda në qytet përgjatë shetitores "1 Maji". Është një plazh më rërë, ujë të pastër dhe mundësi për argëtim. Në Pogradec ka edhe disa plazhe të tjerë private e publike, me rërë e guralece të vegjël. Jashtë qytetit janë plazhet me ujë të kristaltë të Linit dhe Tushëmishtit. Pogradeci ka një muze të pasur me dëshmi antikiteti dhe të kohës së luftës, ka kishën e vjetër ortodokse, që quhet kisha e Shën Mërisë dhe ndodhet në lagjen e vjetër të Pogradecit, si dhe një kishë të re, më arkitekturë shumë të vecante të quajtur Ringjallja. Qyteti gjithashtu ka dy xhami. Njera ndodhet në qendër të qytetit dhe tjetra në lagjen e quajtur Goricë.

Katër kilometër në lindje të Pogradecit ndodhet pika turistike të Drilonit.

6.1 Organizimi dhe funksionimi i Komunes se Pogradecit

Rrethi i Pogradecit përbëhet nga një bashki dhe shtatë komuna që janë: ²⁹

- ***Bashkia Pogradec***
- ***Komuna Buçimas***
- ***Komuna Çërravë***
- ***Komuna Dardhas***
- ***Komuna Hudënisht***
- ***Komuna Proptisht***
- ***Komuna Trebinjë***
- ***Komuna Velçan***

²⁹ Silvana Lalo; Njohuritë themelore të vetëqeverisjes lokale në Shqipëri, Tiranë, 1994 (Në studimin e Institutit për Vetëqeverisje Lokale dhe Shërbime Publike) Budapest, 1994, faqe 11.

Qytetarët e Pogradecit përmes përfaqësuesve të tyre ose me pjesëmarrje të drejtëpërdrejtë i realizojnë nevojat e tyre me karakter lokal.

6.2 Bashkëpunimi i Komunës së Strugës me Komunen e Pogradecit

Siç përmendëm më lartë, Komuna e Strugës bashkëpunon me shumë komuna të tjera në sektore të ndryshme. Në vijim do të paraqes disa bashkëpunime (dokumenta zyrtarë) të Komunës së Strugës me komunat e tjera ndër të cilat janë bashkëpunime me komunën e Silistrës, Durrësit, Mitrovicës dhe Pogradecit.

Në vazhdim do të paraqesim disa memorandume të bashkëpunimit të Komunës së Strugës me komunat si vijon:



Republika e Maqedonisë

Komuna e Strugës

Tel. 046/781 335, 781 223, 782 015, Fax: 046/ 781 434

Web: www.struga.gov.mk dhe www.e-struga.gov.mk

Email: kryetari@struga.gov.mk, info@struga.gov.mk

Në bazë të nenit 14 paragrafi 4 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale /“ Gazeta zyrtare e RM-së“ nr.5/02, sot në datën 13.05.2008 në Strugë - R. e Maqedonisë, Kryetari i komunës së Strugës dhe Kryetari i Komunës së Silistrës – R. e Bullgarisë, në mënyrë solemne vërtetuan dëshirën e qytetarëve dhe pushteteve lokale për vendosjen e bashkëpunimit të përhershëm ndërkomunal dhe marrëdhënieve miqësore, dhe nënshkruan

Vendim

Për vëllazërim të Strugës dhe Silistrës

Kryetari i Komunës së Strugës z. Ramiz Merko dhe Kryetari i Komunës së Silistrës z. Ivo Andonov sot në datën 13.05.2008 në Strugë në mënyrë solemne vërtetuan aktin e vëllazërimit me nënshkrimin e Vendimit me të cilën solemnisht obligohen në emër të qytetarëve të komunave të cilët i përfaqësojnë dhe përfaqësuesit organeve të komunave, se:

1. Plotësisht dhe në mënyrë organizative do të punojnë në njohjen më të mirë të përbashkët, mirëkuptimit dhe afritit të qytetarëve të Strugës dhe Silistrës.
2. Në mënyrë reciproke do të organizojnë vizita të përbashkëta të pushteteve lokale, të ekspertëve të komunave, biznesmenëve dhe shërbimeve profesionale për arsye të këmbimit të eksperiencave, harmonizimit të dispozitave dhe avancimit të punës në të gjitha nivelet.

3. Do të punojnë në identifikimin e krahinave të mundshme dhe mënyrave të bashkëpunimit ekonomik dhe do të ndërmjetsojnë vendosjen e kontakteve të subjekteve ekonomike.
4. Sëbashku do të punojnë në njohjen më të afërt të qytetarëve për arsye të krijimit të kushteve për jetesë të qetë, begati të komunave të tyre dhe më gjërë në rajonin e Europës dhe botës.
5. Do të organizojnë bashkëpunim dhe këmbim në sferën e kulturës, sportit, turizmit dhe organizatave të tjera dhe individë.
6. Do të inicojnë, organizojnë dhe mbështesin këmbimin e bashkëpunimeve të formave kulturore të përbashkëta, e thurrur përmes koncerteve muzikore, manifestimeve kulturore, shfaqjet teatrale, etj
7. Do të punojnë në realizimin e programeve konkrete në interes të komunave
8. Do të përkrahin dhe stimulojnë punën e organizatave jo-qeveritare si një urë miqësore e afrimit dhe bashkëpunimit të qytetarëve dhe grupeve etnike të të dy qyteteve.
9. Turizmi si një shenjë e njohur i të dy qyteteve do të vlerësohet shumë në zhvillimin e tij dhe do të punohet në bashkëpunimin e përbashkët të avancimit dhe zhvillimit të turizmit dhe ndërmjetsimit të turizmit.

Vendimi për vëllazërim të Strugës dhe Silistrës do të hyjë ne fuqi me ratifikimin e këshillave të Komunës së Strugës dhe Komunës së Silistrës.

Komuna e Silistrës

Kryetar,
Ivo Andonov

Komuna e Strugës

Kryetar,
Ramiz Merko



Republika e Maqedonisë

Komuna e Strugës

Tel. 046/781 335, 781 223, 782 015, Fax: 046/ 781 434

Web: www.struga.gov.mk dhe www.e-struga.gov.mk

Email: kryetari@struga.gov.mk, info@struga.gov.mk

Në bazë të nenit 14 paragrafi 4 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale /“ Gazeta zyrtare e RM-së“ nr.5/02, sot në datën 12.06.2010 në Durrës - R. e Shqipërisë, Kryetari i komunës së Strugës dhe Kryetari i Komunës së Durrësit – R. e Shqipërisë, në mënyrë solemne vërtetuan dëshirën e qytetarëve dhe pushteteve lokale për vendosjen e bashkëpunimit të përhershëm ndërkomunal dhe marrëdhënieve miqësore, dhe nënshkruan

Vendim

Për vëllazërim të Strugës dhe komunës së Durrësit

Kryetari i Komunës së Strugës z. Ramiz Merko dhe Kryetari i Komunës së Durrësit z. Vangjush Dako sot në datën 12.06.2010 në Durrës në mënyrë solemne vërtetuan aktin e vëllazërimit me nënshkrimin e Vendimit me të cilën solemnisht obligohen në emër të qytetarëve të komunave të cilët i përfaqësojnë dhe përfaqësuesit organeve të komunave, se:

1. Plotësisht dhe në mënyrë organizative do të punojnë në njohjen më të mirë të përbashkët, mirëkuptimit dhe afrimit të qytetarëve të Strugës dhe Komunës së Durrësit.
2. Në mënyrë reciproke do të organizojnë vizita të përbashkëta të pushteteve lokale, të ekspertëve të komunave, biznesmenëve dhe shërbimeve profesionale për arsye të këmbimit të eksperiencave, harmonizimit të dispozitave dhe avancimit të punës në të gjitha nivelet.

3. Do të punojnë në identifikimin e krahinave të mundshme dhe mënyrave të bashkëpunimit ekonomik dhe do të ndërmjetsojnë vendosjen e kontakteve të subjekteve ekonomike.
4. Sëbashku do të punojnë në njohjen më të afërt të qytetarëve për arsye të krijimit të kushteve për jetesë të qetë, begati të komunave të tyre dhe më gjërë në rajonin e Europës dhe botës.
5. Do të organizojnë bashkëpunim dhe këmbim në sferën e kulturës, sportit, turizmit dhe organizatave të tjera dhe individë.
6. Do të inicojnë, organizojnë dhe mbështesin këmbimin e bashkëpunimeve të formave kulturore të përbashkëta, e thurrur përmes koncerteve muzikore, manifestimeve kulturore, shfaqjet teatrale, etj
7. Do të punojnë në realizimin e programeve konkrete në interes të komunave
8. Do të përkrahin dhe stimulojnë punën e organizatave jo-qeveritare si një urë miqësore e afrimit dhe bashkëpunimit të qytetarëve dhe grupeve etnike të të dy qyteteve.
9. Turizmi si një shenjë e njohur i të dy qyteteve do të vlerësohet shumë në zhvillimin e tij dhe do të punohet në bashkëpunimin e përbashkët të avancimit dhe zhvillimit të turizmit dhe ndërmjetsimit të turizmit.

Vendimi për vëllazërim të Strugës dhe Komunës së Durrësit do të hyjë ne fuqi me ratifikimin e këshillave të Komunës së Strugës dhe Komunës së Durrësit.

Komuna e Durrësit

Kryetar,
Vangjush Dako

Komuna e Strugës

Kryetar,
Ramiz Merko



Republika e Maqedonisë

Komuna e Strugës

Tel. 046/781 335, 781 223, 782 015, Fax: 046/ 781 434

Web: www.struga.gov.mk dhe www.e-struga.gov.mk

Email: kryetari@struga.gov.mk, info@struga.gov.mk

Në bazë të nenit 14 paragrafi 4 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale /“ Gazeta zyrtare e RM-së“ nr.5/02, sot në datën 23.05.2008 në Strugë - R. e Maqedonisë, Kryetari i komunës së Strugës dhe Kryetari i Komunës së Mitrovicës – R. e Kosovës, në mënyrë solemne vërtetuan dëshirën e qytetarëve dhe pushteteve lokale për vendosjen e bashkëpunimit të përhershëm ndërkomunal dhe marrëdhënieve miqësore, dhe nënshkruan

Vendim

Për vëllazërim të Strugës dhe Mitrovicës

Kryetari i Komunës së Strugës z. Ramiz Merko dhe Kryetari i Komunës së Mitrovicës z. Bajram Rexhepi sot në datën 23.05.2008 në Strugë në mënyrë solemne vërtetuan aktin e vëllazërimit me nënshkrimin e Vendimit me të cilën solemnisht obligohen në emër të qytetarëve të komunave të cilët i përfaqësojnë dhe përfaqësuesit organeve të komunave, se:

1. Plotësisht dhe në mënyrë organizative do të punojnë në njohjen më të mirë të përbashkët, mirëkuptimit dhe afrimit të qytetarëve të Strugës dhe Mitrovicës.
2. Në mënyrë reciproke do të organizojnë vizita të përbashkëta të pushteteve lokale, të ekspertëve të komunave, biznesmenëve dhe shërbimeve profesionale për arsye të këmbimit të eksperiencave, harmonizimit të dispozitave dhe avancimit të punës në të gjitha nivelet.

3. Do të punojnë në identifikimin e krahinave të mundshme dhe mënyrave të bashkëpunimit ekonomik dhe do të ndërmjetsojnë vendosjen e kontakteve të subjekteve ekonomike.
4. Sëbashku do të punojnë në njohjen më të afërt të qytetarëve për arsye të krijimit të kushteve për jetesë të qetë, begati të komunave të tyre dhe më gjërë në rajonin e Europës dhe botës.
5. Do të organizojnë bashkëpunim dhe këmbim në sferën e kulturës, sportit, turizmit dhe organizatave të tjera dhe individë.
6. Do të inicojnë, organizojnë dhe mbështesin këmbimin e bashkëpunimeve të formave kulturore të përbashkëta, e thurrur përmes koncerteve muzikore, manifestimeve kulturore, shfaqjet teatrale, etj
7. Do të punojnë në realizimin e programeve konkrete në interes të komunave
8. Do të përkrahin dhe stimulojnë punën e organizatave jo-qeveritare si një urë miqësore e afrimit dhe bashkëpunimit të qytetarëve dhe grupeve etnike të të dy qyteteve.
9. Turizmi si një shenjë e njohur i të dy qyteteve do të vlerësohet shumë në zhvillimin e tij dhe do të punohet në bashkëpunimin e përbashkët të avancimit dhe zhvillimit të turizmit dhe ndërmjetsimit të turizmit.

Vendimi për vëllazërim të Strugës dhe Mitrovicës do të hyjë në fuqi me ratifikimin e këshillave të Komunës së Strugës dhe Mitrovicës.

Komuna e Mitrovicës

Kryetar,
Bajram Rexhepi

Komuna e Strugës

Kryetar,
Ramiz Merko

6.3 Komuna e Strugës dhe bashkëpunimi i saj me Komunën e Pogradecit

Bashkëpunimi ndërmjet këtyre dy komunave jo vetëm që është i dëshirueshëm por ai është edhe i domosdoshëm për shkak të pozitës gjeografike që e kanë dhe për shkak të një kufiri që padrejtësisht është i vendosur në mes të shqipëtarëve të kësaj dhe asaj anë të një trangu.

Historia ka qënë e hidhur dhe ky kufi ka ndarë këtë popull 45 vite radhazi. Por nga fillimi i Vitit 1991 fillon komunikimi në mes këtyre dy komunave.

Ky komunikim shtohet në mënyrë permanente por lë akoma për të dëshiruar për shkak se nuk është në nivelin e duhur, të dëshirueshëm dhe të domosdoshëm për zhvillimin e dy komunave.

Bashkëpunimi në mes Komunës së Strugës dhe Pogradecit bëhet në shumë lëmi si: në fushën ekonomike , tregëtisë, mbrojtjes së mjedisit jetësor, turizmit, kulturës, sportit, shëndetësisë, etj.

Gjatë stinës së verës zhvillohen edhe shumë aktivitete kulturore, sportive ndërkomunale por edhe me karakter ndërkombëtar.

Në këtë drejtim zhvillohen edhe aktivitete të ndryshme dhe ndër to mund të përmendimi Ditën e Liqenit të Ohrit kur tre komunat së bashku kurorzojnë aktivitetet e tyre të përbashkëta me manifestime të ndryshme.

Mbrojtja e Liqenit të Ohrit si pasuri kombëtare me vlera të medha historike, kulturore, turistike duhet të bëhet me një përkushtim të theksuar ashtu siç përfshin Konventat ndërkombëtare të mbrojtjes së mjedisit si dhe ligjet nacionale të dy vendeve.

Kjo për faktin se Liqeni i Ohrit për shkak të vlerave që ka që nga viti 1981 është shpallur pasuri ndërkombëtare dhe së bashku me Qytetin e Ohrit është nën mbrojtjen e UNESCO.³⁰

Me investime të UNESCO dhe Shtetit Shqiptar është rregulluar edhe pjesa bregliqenore e Qytetit të Pogradecit dhe si rezultat i kësaj në Janar të Vitit 2019 pritet që edhe pjesa Shqiptare e Liqent të shpallet zonë e mbrojtur nga UNESCO.

Këto janë disa fakte që duhet t'i ketë parasysh edhe Pushteti Lokal në Qytetin e Strugës dhe në kohë sa me të shkurtër të reflektoje pozitivitetet në mbrojtje e kësaj pjese të Liqenit për t'u bashkangjitur dy qyteteve tjera Ohrit dhe Pogradecit dhe të marrë Statusin e mbrojtjes nga UNESCO.

• ³⁰ www.struga.gov.mk

• www.pogradec.gov.al

Me interes të veçantë janë edhe përpjekjet për vënien në funksion të linjës ujore Strugë – Pogradec, Pogradec – Ohër, Ohër-Strugë dhe anasjelltas, për shkak se këto linja jo vetëm që do të përmbushin kërkesat dhe dëshirat e popullatës së tri komunave por edhe do të mundësojë edhe zhvillimin e turizmit nomad dhe do të rrisë shkallën e përfitimit nga dega e turizmit. Disa herë është vënë në lëvizje por për fat të keq edhe është ndërprerë.

Pengesat gjithmonë janë paraqitur nga pala Maqedone gjoja teknike por ato cdo herë kanë konsistuar se kanë qënë të pabazuara

Megjithatë përpjekjet për vënien e një linje të rregullt nuk duhet të nderpriten pasi kjo linjë do të ju mundësojë qytetarëve të realizojnë një qarkullim të lirë të tyre dhe shfrytëzimin e shërbimeve efikase dhe cilësore në fushën e turizmit.

Janë realizuar pjesërisht dhe tërësisht projekte të përbashkëta si:

Ndërtimi i Kolektorëve për ujërat e zeza nga Radozhda deri në Kalishtë në Komunën e Strugës nga ana e Pogradecit ndërtimi i kolektorëve për pastrimin e ujerave të zeza prej Tushemishti deri në Lin.

Pastaj kemi edhe marrëveshjet lidhur me ndalimin e peshkimit pa kriter si dhe ruajtjen e prerjes së kallamishteve si vende ku bëhet shumimi natyral i peshkut.

Në vazhdim kemi memorandumin e bashkëpunimit të Pogradecit ,Strugës dhe Ohrit.

Memorandum Bashkëpunimi Pogradec-Strugë-Ohër

06/02/2016

Bashkia e Pogradecit dhe Komunitet e Strugës dhe Ohrit nënshkruan një memorandum bashkëpunimi në Wismar të Gjermanisë për të rritur bashkëpunimin në fushën e turizmit, ruajtjen e mjedisit si dhe shfrytëzimin e të gjitha resurseve e vlerave të Liqenit të Ohrit, duke marrë për bazë modelin gjerman.

Kryetari i Bashkisë së Pogradecit, homologu i tij i Komunës së Strugës, dhe përfaqësues të komunës së Ohrit ishin pjesë e një organizimi të zhvilluar në Wismar nga organizatat “Christlicher Hilfsverein Wismar” dhe “Konrad-Adenauer Foundation”. Memorandumi, i pari i këtij lloji, do të pasohet nga një marrëveshje më e gjerë bashkëpunimi mes 3 bashkive në muajin mars.

Të 3 bashkitë do të angazhohen për projekte të përbashkëta për të rritur turizmin dhe shkëmbimet mes tyre. Kryebashkiaku i Pogradecit deklaroi se ky memorandum do të ketë modelin gjerman si mbështetje.

Intervista e realizuar me Kryetarin e Komunës së Strugës Z. Ramiz Merko

Çka mendoni për bashkëpunimin e Komunës së Strugës me Komunën e Pogradecit?

Bashkëpunimi ne nivel shteti është një anë e medaljes që është i domosdoshëm, bashkëpunimi komunave me qeverinë apo edhe ministrinë është i rendësishëm si dhe bashkëpunimi mes komunave fqinje apo edhe bashkëpunimi ndërkufitar për shembull bashkëpunimi i komunës së Strugës me bashkinë e Pogradecit është i domosdoshëm në drejtimin e zhvillimit të turizmit shfrytëzimin e mjeteve financiare nga IPA fondet të cilat kërkojnë projektet të thithen për përmirësimin e kushteve më të mira për jetes, bashkëpunimi ndikon pozitivisht në lëvizjen e lirë të njerzëve dhe mallrave.

Ne cilat fusha keni bashkepunuar?

Ne jemi komuna të binjakëzuara dhe bashkëpunim kryesor kemi ne fushën e turizmit, dhe pikërisht çdo vit njëra nga komunat Strugës apo Pogradecit hap sezonin turistik ku kjo manifestohet me një festë bashkë edhe me administratat e komunave, këshillave komunal organizatat joqeveritare njerëz të fushës të biznesit veçanërisht hotelëritë kapacitetet që i ofrojnë, bashkëpunimi vazhdon në mbrojtjen e pyjeve dhe resurseve të tjera natyrore.

Çka mund të na thoni për mosvënien e linjës së rregullt ujore Strugë – Pogradec – Ohër dhe anasjelltas ?

Kushtet teknike kanë ndikuar për mosvënien në funksion të linjës ujore Strugë – Pogradec – Ohër dhe anasjelltas, marrëveshja u nënshkruar për të funksionuar vetëm për sezonin e verës por nuk pati sukses të funksiononte sepse nuk janë plotësuar kushtet optimale për funksionimin e linjës ujore.

A mendoni se bashkëpunimi në mes komunave është në nivelin e duhur?

Jo, jo. Përpjekjet tona nuk do të ndërpriten asnjëherë se në do të bejme ç do gjë që është e mundur për ta shtuar vazhdimisht bashkëpunimin tonë në të gjitha sferat e jetës.

Intervista e realizuar me Kryetarin e Komunës së Pogradecit Z. Eduard Kapri

Çka mendoni për bashkëpunimin e Komunës së Strugës me Komunën e Pogradecit?

Kemi bashkëpunim të mirë ky bashkëpunim ka qenë i hershëm që në takimit që bëhen në mes të tre bashkive asaj të Pogradecit të Strugës dhe Ohrit në çdo 21 Qershor ku bëjmë hapjen e sezonit turistik me një takim simbolik, ku sipas radhës këtë takim simjet duhet ta organizoj bashkia e Pogradecit. Me Komunën e Strugës kemi bërë edhe organizime të tjera nëpër shkollat e Strugës për shkëmbim eksperiencash, është bërë edhe një broshurë për këto tre Qytetet më tepër për promovimin e turizmit.

Në cilat fusha keni bashkëpunuar?

Siç thashë edhe më lartë në fushën e turizmit, në promovimin e qyteteve tona, shpresoj që të kemi bashkëpunim edhe në fusha të tjera në fushën e kultures të sportit etj.

Çka mund të na thoni për mosvënien e linjës së rregullt ujore Strugë – Pogradec – Ohër dhe anasjelltas ?

Ka funksionuar linja vetëm një rrugëtim por për shkak të mungesës të infrastruktures nuk mundi të vazhdojë së funksionuari sepse portin ku e kemi në është mjaftueshëm i ulët dhe nuk mund ta përballojë atë fluks të rrugëtarëve dhe të anijeve lundruese.

A mendoni se bashkëpunimi në mes komunave është në nivelin e duhur?

Themi çdo herë edhe pse kemi bashkëpunim të mirë ka vend për përmirësim ku të jemi më të koordinuar për shfrytëzimin e potencialit në fushën e turizmit për promovimin e liqenit tonë të përbashkët ku shpresoj t'i japim zhvillim më të mirë ekonomisë të dy Qyteteve.

7. Analize krahasuese e nivelit të rritjes së bashkëpunimit ndërkufitar

Në bazë të studimit tonë bashkëpunimi në mes të Komunës së Strugës dhe Pogradecit nuk është në nivelin e dëshiruar. Për disa fusha ekziston bashkëpunim i mirëfilltë si ato kulturore, sportive, artistike, etj. Ndërsa në fushat që sjellin prosperitet ekonomik si zhvillimi i turizmit, zhvillimi tregëtar , ekonomik, mbrojtja e mjedisit jetësor, e sidomos mbrojtja e Liqenit të Ohrit si vlerë e pakontestuar që sjell zhvillim për gjithë rajonin nuk është në nivelin e duhur.

Nga intervistat e dy Kryetarëve të Komunës së Strugës dhe Komunës së Pogradecit shihet se ekziston vullnet pozitiv për një bashkëpunim të mirëfilltë , të cilin ato institucionalisht dhe vullnet personal dëshirojnë ta realizojnë. Poashtu edhe nga intervistat e qytetarëve të cilët kanë mendim se bashkëpunimi në mes komunave duhet të rritet dukshëm domosdoshmërisht, për shkak se me bashkëpunim të mirëfilltë do të ketë zhvillim ekonomik, zhvillim të turizmit, zhvillim të tregëtisë gjë që do të mundësonte rritjen e standardit të bregliqenasve të Liqenit të Ohrit.

Gjatë studimit empirik u intervistuan më së 120 qytetarë të Komunës së Strugës dhe po aq qytetarë edhe nga Komuna e Pogradecit. Qytetarët kanë qënë të punësuar në Komunën e Strugës si këshilltarë, punëtorë të administratës, etj. Si dhe të grupmoshave të ndryshme.

Ndërsa nga anketimi i qytetarëve shihet qartë se 98% e tyre nuk janë të kënaqur me bashkëpunimin aktual në mes të komunave. Por dëshirojnë rritjen e shkallës së bashkëpunimit.

Për të pasur qasje vizuale më të qartë rezultatet e anketimit tonë do të paraqiten në formën tabelare dhe të grafikoneve :

Pyetesorit të parë i cili ka përfshirë 120 të anketuar rezultatet janë si në figurën 1.




Fig. 1.

Nga grafiku i mësipërm vërehet se pjesa më e madhe e personave të anketuar në studimin tonë janë të grupmoshës 36-45 vjeçare. Në fakt nga gjithsej 120 persona të anketuar vetëm 7 ose 6 % janë të grupmoshës 20-25 vjeçare dhe vetëm 9 persona ose 7 % janë të moshës mbi 55 vjeçare. Nga ana tjetër 40 persona ose 34 % nga numri i përgjithshëm të të anketuarve janë të moshës 36-45 vjeçare, 33 persona ose 28 % janë të moshës 26-35 vjeçare dhe 31 ose 25 % janë të moshës 45-55 vjeçare. Për këtë studim është me rëndësi edhe niveli i arsimimit të të anketuarve dhe në këtë drejtim i kemi të dhënat e përfshira në figuren nr 2.




Fig nr 2

Nga ky grafik vërehet se pjesa më e madhe e personave të anketuar, me shkollë fillore janë rreth 11 % , (37%) janë me arsim të mesëm dhe rreth 44.6% janë me arsim të lartë të kryeri të të anketuarve dhe me shkollë të lartë të kryer rreth 8.4 % i personave të anketuar.

Ne pyetjen a jeni të kënaqur me bashkëpunimin në mes Komunave të Strugës dhe Pogradecit të anketuarit janë përgjigjur si vijon:

Tabela 1.

	po	pjesërisht	jo	nuk kam përgjigje
1. A jeni të kënaqur me bashkëpunimin në mes Komunave të Strugës dhe Pogradecit	8	16	96	0

Nga pyetja se sa janë të kënaqur me bashkëpunimin e dy komunave qartësisht të intervistuarit përgjigjen edhe atë me përqindje 80%, që nuk janë të kënaqur.



Fig. nr. 3

Në pyetjen **A mendoni se duhet të rritet shkalla e bashkëpunimit të Komunës së Strugës dhe Pogradecit** të anketuarit janë përgjigjur si vijon

Tabela nr. 2

	po	pjesërisht	Jo	nuk kam përgjigje
2. A mendoni se duhet të rritet shkalla e bashkëpunimit të Komunës së Strugës dhe Pogradecit?	116	4	0	0




Figura nr. 4

Në pyetjen **A mendoni se vënia e linjës ujore Strugë – Pogradec duhet të vihet në funksion** të anketuarit janë përgjigjur si vijon

	po	ndoshta	jo	nuk kam përgjigje
3. A mendoni se vënia e linjës ujore Strugë – Pogradec duhet të vihet në funksion?	118	2	0	0

Tabela nr. 3



Fig nr. 5

Në pyetjen **A mendoni se shkalla e ulët e bashkëpunimit në mes Komunës së Strugës dhe Pogradecit është rezultat i pengesave ligjore** të anketuarit janë përgjigjur si vijon

	po	ndoshta	Jo	nuk kam përgjigje
4 . A mendoni se shkalla e ulët e bashkëpunimit në mes Komunës së Strugës dhe Pogradecit është rezultat i pengesave ligjore	14	7	99	0

Tabela nr. 4




Fig nr. 6

8.Shtojcë (Aneks)



Republika e Maqedonisë

Komuna e Strugës

Tel. 046/781 335, 781 223, 782 015, Fax: 046/ 781 434

Web: www.struga.gov.mk dhe www.e-struga.gov.mk

Email: kryetari@struga.gov.mk, info@struga.gov.mk

Në bazë të nenit 14 paragrafi 4 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale /“ Gazeta zyrtare e RM-së“ nr.5/02, sot në datën 13.05.2008 në Strugë - R. e Maqedonisë, Kryetari i komunës së Strugës dhe Kryetari i Komunës së Silistrës – R. e Bullgarisë, në mënyrë solemne vërtetuan dëshirën e qytetarëve dhe pushteteve lokale për vendosjen e bashkëpunimit të përhershëm ndërkomunal dhe marrëdhënieve miqësore, dhe nënshkruan

Vendim

Për vëllazërim të Strugës dhe Silistrës

Kryetari i Komunës së Strugës z. Ramiz Merko dhe Kryetari i Komunës së Silistrës z. Ivo Andonov sot në datën 13.05.2008 në Strugë në mënyrë solemne vërtetuan aktin e vëllazërimit me nënshkrimin e Vendimit me të cilën solemnisht obligohen në emër të qytetarëve të komunave të cilët i përfaqësojnë dhe përfaqësuesit organeve të komunave, se:

- 10.** Plotësisht dhe në mënyrë organizative do të punojnë në njohjen më të mirë të përbashkët, mirëkuptimit dhe afrimit të qytetarëve të Strugës dhe Silistrës.
- 11.** Në mënyrë reciproke do të organizojnë vizita të përbashkëta të pushteteve lokale, të ekspertëve të komunave, biznesmenëve dhe shërbimeve profesionale për arsye të këmbimit të eksperiencave, harmonizimit të dispozitave dhe avancimit të punës në të gjitha nivelet.

- 12.** Do të punojnë në identifikimin e krahinave të mundshme dhe mënyrave të bashkëpunimit ekonomik dhe do të ndërmjetsojnë vendosjen e kontakteve të subjekteve ekonomike.
- 13.** Sëbashku do të punojnë në njohjen më të afërt të qytetarëve për arsye të krijimit të kushteve për jetesë të qetë, begati të komunave të tyre dhe më gjërë në rajonin e Europës dhe botës.
- 14.** Do të organizojnë bashkëpunim dhe këmbim në sferën e kulturës, sportit, turizmit dhe organizatave të tjera dhe individë.
- 15.** Do të inicojnë, organizojnë dhe mbështesin këmbimin e bashkëpunimeve të formave kulturore të përbashkëta, e thurrur përmes koncerteve muzikore, manifestimeve kulturore, shfaqjet teatrale, etj
- 16.** Do të punojnë në realizimin e programeve konkrete në interes të komunave
- 17.** Do të përkrahin dhe stimulojnë punën e organizatave jo-qeveritare si një urë miqësore e afrimit dhe bashkëpunimit të qytetarëve dhe grupeve etnike të të dy qyteteve.
- 18.** Turizmi si një shenjë e njohur i të dy qyteteve do të vlerësohet shumë në zhvillimin e tij dhe do të punohet në bashkëpunimin e përbashkët të avancimit dhe zhvillimit të turizmit dhe ndërmjetsimit të turizmit.

Vendimi për vëllazërim të Strugës dhe Silistrës do të hyjë në fuqi me ratifikimin e këshillave të Komunës së Strugës dhe Komunës së Silistrës.

Komuna e Silistrës

Kryetar,
Ivo Andonov

Komuna e Strugës

Kryetar,
Ramiz Merko



Republika e Maqedonisë

Komuna e Strugës

Tel. 046/781 335, 781 223, 782 015, Fax: 046/ 781 434

Web: www.struga.gov.mk dhe www.e-struga.gov.mk

Email: kryetari@struga.gov.mk, info@struga.gov.mk

Në bazë të nenit 14 paragrafi 4 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale /“ Gazeta zyrtare e RM-së“ nr.5/02, sot në datën 12.06.2010 në Durrës - R. e Shqipërisë, Kryetari i komunës së Strugës dhe Kryetari i Komunës së Durrësit – R. e Shqipërisë, në mënyrë solemne vërtetuan dëshirën e qytetarëve dhe pushteteve lokale për vendosjen e bashkëpunimit të përhershëm ndërkomunal dhe marrëdhënieve miqësore, dhe nënshkruan

Vendim

Për vëllazërim të Strugës dhe komunës së Durrësit

Kryetari i Komunës së Strugës z. Ramiz Merko dhe Kryetari i Komunës së Durrësit z. Vangjush Dako sot në datën 12.06.2010 në Durrës në mënyrë solemne vërtetuan aktin e vëllazërimit me nënshkrimin e Vendimit me të cilën solemnisht obligohen në emër të qytetarëve të komunave të cilët i përfaqësojnë dhe përfaqësuesit organeve të komunave, se:

- 10.** Plotësisht dhe në mënyrë organizative do të punojnë në njohjen më të mirë të përbashkët, mirëkuptimit dhe afrimit të qytetarëve të Strugës dhe Komunës së Durrësit.
- 11.** Në mënyrë reciproke do të organizojnë vizita të përbashkëta të pushteteve lokale, të ekspertëve të komunave, biznesmenëve dhe shërbimeve profesionale për arsye të këmbimit të eksperiencave, harmonizimit të dispozitave dhe avancimit të punës në të gjitha nivelet.

- 12.** Do të punojnë në identifikimin e krahinave të mundshme dhe mënyrave të bashkëpunimit ekonomik dhe do të ndërmjetsojnë vendosjen e kontakteve të subjekteve ekonomike.
- 13.** Sëbashku do të punojnë në njohjen më të afërt të qytetarëve për arsye të krijimit të kushteve për jetesë të qetë, begati të komunave të tyre dhe më gjërë në rajonin e Europës dhe botës.
- 14.** Do të organizojnë bashkëpunim dhe këmbim në sferën e kulturës, sportit, turizimit dhe organizatave të tjera dhe individë.
- 15.** Do të inicojnë, organizojnë dhe mbështesin këmbimin e bashkëpunimeve të formave kulturore të përbashkëta, e thurrur përmes koncerteve muzikore, manifestimeve kulturore, shfaqjet teatrale, etj
- 16.** Do të punojnë në realizimin e programeve konkrete në interes të komunave
- 17.** Do të përkrahin dhe stimulojnë punën e organizatave jo-qeveritare si një urë miqësore e afrimit dhe bashkëpunimit të qytetarëve dhe grupeve etnike të të dy qyteteve.
- 18.** Turizmi si një shenjë e njohur i të dy qyteteve do të vlerësohet shumë në zhvillimin e tij dhe do të punohet në bashkëpunimin e përbashkët të avancimit dhe zhvillimit të turizmit dhe ndërmjetsimit të turizmit.

Vendimi për vëllazërim të Strugës dhe Komunës së Durrësit do të hyjë ne fuqi me ratifikimin e këshillave të Komunës së Strugës dhe Komunës së Durrësit.

Komuna e Durrësit

Kryetar,

Vangjush Dako

Komuna e Strugës

Kryetar,

Ramiz Merko



Republika e Maqedonisë

Komuna e Strugës

Tel. 046/781 335, 781 223, 782 015, Fax: 046/ 781 434

Web: www.struga.gov.mk dhe www.e-struga.gov.mk

Email: kryetari@struga.gov.mk, info@struga.gov.mk

Në bazë të nenit 14 paragrafi 4 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale /“ Gazeta zyrtare e RM-së“ nr.5/02, sot në datën 23.05.2008 në Strugë - R. e Maqedonisë, Kryetari i komunës së Strugës dhe Kryetari i Komunës së Mitrovicës – R. e Kosovës, në mënyrë solemne vërtetuan dëshirën e qytetarëve dhe pushteteve lokale për vendosjen e bashkëpunimit të përhershëm ndërkomunal dhe marrëdhënieve miqësore, dhe nënshkruan

Vendim

Për vëllazërim të Strugës dhe Mitrovicës

Kryetari i Komunës së Strugës z. Ramiz Merko dhe Kryetari i Komunës së Mitrovicës z. Bajram Rexhepi sot në datën 23.05.2008 në Strugë në mënyrë solemne vërtetuan aktin e vëllazërimit me nënshkrimin e Vendimit me të cilën solemnisht obligohen në emër të qytetarëve të komunave të cilët i përfaqësojnë dhe përfaqësuesit organeve të komunave, se:

- 10.** Plotësisht dhe në mënyrë organizative do të punojnë në njohjen më të mirë të përbashkët, mirëkuptimit dhe afrimit të qytetarëve të Strugës dhe Mitrovicës.
- 11.** Në mënyrë reciproke do të organizojnë vizita të përbashkëta të pushteteve lokale, të ekspertëve të komunave, biznesmenëve dhe shërbimeve profesionale për arsye të këmbimit të eksperiencave, harmonizimit të dispozitave dhe avancimit të punës në të gjitha nivelet.

12. Do të punojnë në identifikimin e krahinave të mundshme dhe mënyrave të bashkëpunimit ekonomik dhe do të ndërmjetsojnë vendosjen e kontakteve të subjekteve ekonomike.
13. Sëbashku do të punojnë në njohjen më të afërt të qytetarëve për arsye të krijimit të kushteve për jetesë të qetë, begati të komunave të tyre dhe më gjërë në rajonin e Europës dhe botës.
14. Do të organizojnë bashkëpunim dhe këmbim në sferën e kulturës, sportit, turizmit dhe organizatave të tjera dhe individë.
15. Do të inicojnë, organizojnë dhe mbështesin këmbimin e bashkëpunimeve të formave kulturore të përbashkëta, e thurrur përmes koncerteve muzikore, manifestimeve kulturore, shfaqjet teatrale, etj
16. Do të punojnë në realizimin e programeve konkrete në interes të komunave
17. Do të përkrahin dhe stimulojnë punën e organizatave jo-qeveritare si një urë miqësore e afrimit dhe bashkëpunimit të qytetarëve dhe grupeve etnike të të dy qyteteve.
18. Turizmi si një shenjë e njohur i të dy qyteteve do të vlerësohet shumë në zhvillimin e tij dhe do të punohet në bashkëpunimin e përbashkët të avancimit dhe zhvillimit të turizmit dhe ndërmjetsimit të turizmit.

Vendimi për vëllazërim të Strugës dhe Mitrovicës do të hyjë në fuqi me ratifikimin e këshillave të Komunës së Strugës dhe Mitrovicës.

Komuna e Mitrovicës

Kryetar,
Bajram Rexhepi

Komuna e Strugës

Kryetar,
Ramiz Merko

Pyetësor

1. A jeni të kënaqur me bashkëpunimin në mes Komunave të Strugës dhe Pogradecit?

Përgjigje:

- *Po*
- *Pjesërisht*
- *Jo*
- *Nuk kam përgjigje*

2. A mendoni se duhet të rritet shkalla e bashkëpunimit të Komunës së Strugës dhe Pogradecit?

Përgjigje:

- *Po*
- *Pjesërisht*
- *Jo*
- *Nuk kam përgjigje*

3. A mendoni se vënia e linjës ujore Strugë – Pogradec duhet të vihet në funksion?

Përgjigje:

- *Po*
- *Ndoshta*
- *Jo*
- *Nuk kam përgjigje*

4. A mendoni se shkalla e ulët e bashkëpunimit në mes Komunës së Strugës dhe Pogradecit është rezultat i pengesave ligjore?

Përgjigje:

- *Po*
- *Ndoshta*
- *Jo*
- *Nuk kam përgjigje*

DATA POGRADEC
572 PROT
DATA 13.06.2014



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TRANSPORTIT
DHE INFRASTRUKTURËS

MINISTRI

Nr. Prot. 656/13

Tiranë, 10 /06/2014

Lënda: Mbi funksionimin e linjës liqenore Ohër – Pogradec

Zotit Saimir Tahiri
Ministër
Ministria e Punëve të Brendshme

Zotit Shkëlqim Cani
Ministër
Ministria e Financave

Zotit Artan Shkëmbi
Kryetar
Bashkia Pogradec ✓

Për dëjën: Zotit Ditmir Bushati
Ministër
Ministria e Punëve të Jashtme

Zonjës Eglantina Gjermeni
Ministër
Ministria e Zhvillimit Urban dhe Turizmit,

Të nderuar Kolegë,
I nderuar zoti Shkëmbi,

Në zbatim të VKM nr. 323, datë 23.05.2014, "Për hapjen e pikës së përkohshme të kalimit kufitar në molin e Pogradecit, në kufirin shtetëror liqenor të Republikës së Shqipërisë me Republikën e Maqedonisë", ju vëmë në dëjën që kjo linjë do të fillojë operimin në datën 15 qershor 2014.

Duke ju falenderuar paraprakisht për bashkëpunimin dhe mbështetjen tuaj, lutemi angazhimin e strukturave përkatëse në funksionimin sa më mirë të kësaj linje.

Me respekt,

Edmond Haxhi



129

10 02 2014



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TRANSPORTIT
DHE INFRASTRUKTURËS

MINISTRI

Nr. Prot. 654

Tiranë, 06 / 02 / 2014

Lënda: Për marrjen e masave për përpunimin e anijeve të pasagjerëve

Zotit Ardit Konomi
Prefekt
Qarku Korçë

Zotit Artan Shkëmbi
Kryetar
Bashkia Pogradec

Zotërinj,

Mbi bazën e detyrave të lëna në takimin e zhvilluar ndërmjet Ministrave të Transportit të Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Maqedonisë, në datën 9 dhjetor 2013, në Ohër, u takuan në Pogradec me datën 17 janar 2014, grupet e eksperteve të të dyja vendeve, me përfaqësues të ministrave të transportit, policisë kufitare, doganës dhe pushtetit vendor (përfshirë edhe përfaqësuesin tuaj), për të diskutuar dhe përcaktuar masat konkrete të secilës palë, për vendosjen e transportit liqenor të pasagjerëve në linjën Ohër – Pogradec, gjatë periudhës 15 prill – 15 tetor 2014. Në këtë takim u përcaktuan detyrat dhe masat përkatëse që do të merren nga secila palë, për transportin e sigurt me anije, dokumentacioni përkatës, procedurat e kapitenerisë, policisë dhe doganës në pikat kufitare, për fillimin e këtij transporti nga 15 prill 2014.

Për realizimin e këtij transporti të rëndësishëm, një nga problemet që doli është gjendja jo e mire e pontilit të peshkimit në Pogradec ku do të akostohen dhe përpunohen anijet e pasagjerëve.

Për sa më sipër, është e nevojshme që nga ana juaj të merren masat e duhura, për riparimin e këtij pontili dhe vendosjen e pajisjeve të nevojshme, për të realizuar në kohë dhe me nivelin e duhur transportin dhe përpunimin e anijeve me pasagjerë.

Me respekt,

Edmond Haxhinasto



129/1
21 02 2014



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT KORÇË

Nr. 184/1 Prot.

Korçë, më 14.02.2014

Lënda: Për marrjen e masave për përpunimin e anijeve të pasagjerëve.

Drejtuar: Z. Artan Shkëmbi
Kryetar i Bashkisë Pogradec

Per dijeni: Z. Luan Maxhari
Nenprefekt i Rrethit Pogradec

POGRADEC

I nderuar Z. Kryetar,

Pas takimit të zhvilluar mes Ministrave të Transportit të Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Maqedonisë dhe takimit vijues mes grupeve të ekspertëve të të dyja vendeve, përfaqesues të ministrive të transportit, policisë kufitare, doganës dhe pushtetit vendor për vendosjen e transportit liqenor të pasagjerëve në linjen Oher – Pogradec, është konstatuar një problem:

Gjëndja jo e pershtatshme e pontilit të peshkimit në Pogradec, vend ku do të akostohen anijet e pasagjerëve.

Lidhur me këtë fakt pengues, duhet që nga ana e institucionit tuaj të merren masat e nevojshme për riparimin e pontilit si dhe vendosjen në të, të pajisjeve të nevojshme për të realizuar në kohë dhe me kushte të larta sigurie transportin dhe përpunimin e anijeve të pasagjerëve.

Ju faleminderit për mirëkuptimin dhe bashkëpunimin.

**PREFEKTI
ARDIT KONOMI**



Adresa: Bulevard "Republika" Tel: 082 242568 / Fax: 082 244020

8. Shqyrtime përfundimtare

Gjatë këtij hulumtimi kam arritur në përfundimin se:

- Bashkëpunimi ndërkomunal është një karakteristikë shumë e rëndësishme që ndikon në zhvillimin dhe organizimin e mirëfilltë të Qeverisjes Lokale, në fushën e turizmit që i karakterizon këto dy qytete si Strugën edhe Pogradecin me klimë të njëjte gjatë gjithë vitit, duhet gjetur zgjidhja në nivel qendror për plotësimin e kushteve për funksionim normal të linjës ujore dhe duhet të mos anashkalohet qyteti i Strugës në këtë projekt duke u zëvendësuar me qytetin e Ohrit.
- Nuk ekzistojnë pengesa ligjore për një bashkëpunim të mirëfilltë të Komunës së Strugës dhe Komunës së Pogradecit sepse ato rregulla që vlejnë për komunikacionin rrugor janë po të njëjta edhe për komunikacionin ujor, duhet të ketë zyrë me polici kufitare që të bëhet kontrolli i pasaportave dhe kontroll i mundëshëm doganor.
- Ekziston një vullnet i paparë i bregliqenasve për bashkëpunim të mirëfilltë të këtyre dy komunave sepse ngrihet niveli i bashkëpunimit në shumë fusha ne veçanti atë të turizmit të promovimit të eksperiencave në fushën e hotelarisë të peshkimit të ruajtjes të ambientin, të ruajtjes së pyjeve, sidomos të promovimit të përbashkët nëpër botë po të këtij liqeni të përbashkët të promovimit dhe mirëmbajtjes së Troftës karakteristike peshkut të liqenit të Ohrit.
- Shkaku i mosrealizimit të mirëfilltë të bashkëpunimit është mosekzistimi i vullnetit real të institucioneve shtetërore qendrore sepse duhet një shtysë edhe nga lart nga dy qeveritë e dy vendeve për zhvillim më të madh të turizmit, vënia në funksion të linjës ujore, promovimi i turizmit malor, pra promovimi i mallit Jabllanica ku së fundmi është marrë një nismë për të shpallur Park Nacional ku me këtë bëhet një aset shumë i rëndësishëm i kësaj zone.
- Në intervistat që kam bërë dhe në pyetjen e kryetarëve të komunave vihet re se duan bashkëpunim akoma më të madh, për zhvillim më të madh të zonës, për

promovimin e këtyre qyteteve kaq të ngjajshme njëri me tjetrin që të ketë lehtësim dhe qarkullim të njerëzve akoma më të lirë.

Hipoteza se gjatë hulumtimeve që kemi bërë kemi arritur në rezultate të cilat na bëjnë të qartë se bashkëpunimi në mes Komunës të Strugës dhe Pogradecit nuk është në nivelin e duhur as sa i përket qarkullimit të mallrave njerëzve dhe shërbimeve dhe se kjo është rezultat i mospasjes të vullnetit të lirë të organëve të pushtetit qendror të dy shteteve por edhe të neglizhencës së organeve të pushtetit lokal pavarësisht që deklarohen se janë të gatshëm të rrisin shkallën e bashkëpunimit. Ky bashkëpunim mund të rritet dukshëm në fushën e turizmit, ruajtjen e ambientit mjedisor në vecanti të liqenit të Ohrit (gjë që fatkeqësisht ditëve të fundit po bëhet një katastrof ekologjike duke heshtur para saj si organet e pushtetit qendror ashtu edhe organet e pushtetit lokal. Situata mund të ndryshoj me një vullnet të madh dhe angazhim perkatës të organeve të pushtetit qendror, pastaj me një bashkëpunim të mirfillt të organeve të pushtetit qendror dhe një ndërgjegjje të pastër të banorëve të liqenit të Ohrit.

9. Literatura e shfrytëzuar

- Alan Norton, International Handbook of Local and Regional Government, Edward Elgar, 1994
- Aliu Agni, Stavileci Esat; Qeverisja Lokale, Tetovë – Prishtinë , 2009.
- Aliu Agni ; Finansimi i njesive te veteqeverisjes lokale ; Vizione, Shkup,2007.
- Aliu, Agni.; Qeverisja lokale në Europën Juglindore me vështrim në IRJ të Maqedonisë, (Punim i Magjistraturës), Prishtinë, 2003,
- Etem Aziri: Sociologjia, Tetove,2007.
- Aziri, Etem. ; Partitë politike dhe demokracia, Shkup, 2004
- Bajrami, Arsim ; Demokracia parlamentare, Prishtinë, 2005
- David C. Nice, Cities, Localities and the Federal Government, in : A Historical Guide to the U.S. Government, Ed bye Geirge T. Kurian, Oxford University Press, 1998
- David, Held: Modeli demokracije, Zagreb, 1990.
- Drumeva, Emilia; Lokalna vlast u Bugarskoj; (Në punimin: Jacanje lokalne vlasti), Magna Agenda, Cigoja, Beograd; 2002
- Farcas, Mihail.; “Pushtetet lokale në Europën Qendrore e Lindore si dhe në komunitetin e shteteve të pavarura (Instituti për vetëqeverisje lokale dhe shërbime publike)“, Budapest, 1994
- Gelevski, S. ;Naum, G. ; Borçe, D. : Upravno pravo, Shkup, 1997.
- Gjorgjeviç, Snezhana.; Renaissance lokalne vlasti, Beograd, 2002
- Hoxha, Artan.; Pushteti vendor në Shqipëri; Stabilisation of Local Government and Public service reform; (Instituti për vetëqeverisje lokale dhe shërbime publike); Budapest; 2000
- Ivanisevic, Stjepan.; Glavni problemi i moguće pravci reforme lokalne samouprave u Hrvatskoj;1999
- Ivanisevic, S.;Kopric, i.; Omajec, J.; Simovic, J.; Vetëqeverisja lokale në Kroaci (Në punimin: Jacanje lokalne vlasti), Magna Agenda, Cigoja, Beograd; 2002;
- John Loughlin, The United Kingdom; From Hypercentralisation to Devolution, in Subnational Democracy in the European Union, Ed. By John Loughlin, Oxford University Press, 2001
- Kjukukov, Stefan.; Njohuritë themelore mbi pushtetet lokale në Bullgari (Antologjia e Institutit për vetëqeverisje lokale dhe shërbime publike), Budapest, 1994

- Klimovski, Savo: Ustaven i politički sistem, Shkup, 1997.
- Koman, P.; Krai E.;Radulesku M.; Stanculesku, G.; Lokalna vlast u Rumani; (Në punimin: Jacanje lokalne vlasti); Beograd, 2002;
- Lalo, Silvana: Njohuritë themelore të vetëqeverisjes lokale në Shqipëri, Tiranë, 1994.
- Levitas, Antony.; Peteri, Gabor.; Reforma sistema finansiranja lokalne samouprave, Beograd, 2004 (palgo centar, beograd)
- Loloçi, Krenar: E drejta kushtetuese, Tiranë, 1997.
- Marina, M.; Dushko, P.; Perisic, D.: Opstinite vo Makedonija, Shkup, 2002.
- Mitkov, V.: Lokalnata samouprava kako demokratska institucija, Shkup, 1998.
- Mitkov, V.: Ustavot i lokalnata samouprava, Shkup, 1998.
- M.J.F. Goldsmith, K.K. Klausen, European Integration and Local Government, Brookfield, 1997 USA
- Ramlak, Milan. ; Aktuelni problemi centralizacije i decentralizacije, zakonitost – reforma lokalne samouprave, Zagreb, 1990,
- Saliu, Kurtesh: E drejta kushtetuese, Libri II, Prishtinë, 1998.
- Siljanovska D.G.; Mitkov, V.: Lokalna samuprava, Shkup, 2000.
- Stavileci, Esat : Nociione dhe parime të administratës publike, Prishtinë, 2005
- Svetomir, Shkariç: Ustavno pravo, Libri II, Shkup, 1995.
- Todorovski, Ilija: Lokalna samouprava vo Anglia, SAD, i Jugosllavija, Shkup, 1991.
- Todorovski, Ilija: Sovremeni trendovi na lokalnata samouprava vo nekoj Evropshki drzavi, Shkup, 2002
- Veliçkov, I.; Stavrova, E.;Finansirane na mestnite organi za samoupravlenie; Sofje; 2004.
- Zhivko, Todorovski: Parlamentot na Makedonija (organiziranje i funksioniranje) Shkup, 2000.
- Antologji “Pushtetet lokale në Evropën Qendrore e Lindore si dhe në komunitetin e shteteve të pavarura (Instituti për Vetëqeverisjen Lokale dhe Shërbimet Publike)”, Budapest, 1994.

Dokumente Juridike të shfrytëzuara

- Konventa Europiane për Vetëqeverisje Lokale
- Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë
- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë
- Kushtetuta e Republikës së Rumanisë
- Kushtetuta e Republikës së Kroacisë
- Kushtetuta e Republikës së Bullgarisë
- Ligji mbi Financimin e Nevojave të Përbashkëta, Shkup 1991
- Ligji mbi Buxhetin e RM – së, 1991
- Ligji mbi Vetëqeverisjen Lokale, 1995
- Ligji për kontabilitet të buxheteve dhe shfrytëzuesve të buxheteve, Shkup, 2002.
- Ligji për përcaktimin dhe mbledhjen e të ardhurave publike, Shkup 2003.
- Ligji për tatimin e pronës, Shkup 2004.
- Ligji për taksat komunale, Shkup, 2004.
- Ligji për revizion shtetëror, Shkup 2004.
- Ligji për furnizime publike, Shkup 2004.
- Ligji mbi Financimin e Njësive të Vetëqeverisjes lokale, 2005
- Ligji për Zhvillimin e Barabartë Rajonal, Shkup 2008
- Doracak për Kryetarët dhe Këshilltarët e Komunave në RM, Shkup 2005
- Statuti i Komunës së Strugës, 1997
- Statuti i Komunes së Pogradecit,
- Strategjia e decentralizimit dhe autonomisë vendore, Tiranë, 1999

Burime elektronike të shfrytëzuara

- <http://www.mls.gov.mk/>
- www.zels.org.mk
- <http://mk.wikipedia.org/wiki>
- <http://www.scribd.com/doc>
- <http://api.shqiperia.com/kerko/kerkimithjeshte/termi/Vet%EBqeverisja+Lokale>
- <http://nalas.eu/about.aspx>
- <http://www.ento.org/portal/index.php/en/network-presentation-whatisento-27>
- http://www.eurocities.eu/eurocities/about_us
- <http://www.cseecunion.org/>
- http://www.alda-europe.eu/newSite/about_us.php
- <http://www.eurotowns.org/eurotowns#tabs-tabset-2>
- http://www.coe.int/t/congress/presentation/default_en.asp?mytabsmenu=1
- <http://www.coe.al/index.php?faq=content/detail&id=84&mnu=67>
- <http://www.aer.eu/about-aer/history/history-of-the-aer.html>
- http://en.wikipedia.org/wiki/International_organization
- <http://www.hbp.usm.my/conservation/twincities/innovativetwinning.htm>
- <http://en.wikipedia.org/wiki/Phare>
- <http://www.marxists.org/reference/subject/philosophy/works/ot/avineri5.htm>
- www.ohrid.gov.mk
- www.struga.gov.mk
- www.pogradec.gov.al